



Home Office

Kërkesë për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështjet Penale

Udhëzime për Autoritetet jashtë
Mbretërisë së Bashkuar

Mars 2024



© Të drejtat e autorit të kurorës 2022

Ky publikim është i licencuar në përputhje me kushtet e Licencës të Hapur të Qeverisë v3.0, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe. Për të parë këtë licencë, vizitoni faqen nationalarchives.gov.uk/doc/open-government-licence/version/3 ose shkruajini Ekipit për Politikën e Informacionit në adresën The National Archives, Kew, London TW9 4DU, ose dërgoni email në adresën: psi@nationalarchives.gsi.gov.uk.

Aty ku kemi identifikuar ndonjë informacion ku e drejta e autorit i përket palëve të treta, do t'ju nevojitet ta merrni lejen nga mbajtësit përkatës të së drejtës së autorit.

Ky publikim gjendet në faqen [MLA guidelines for foreign authorities - GOV.UK \(www.gov.uk\)](https://www.gov.uk/mla-guidelines-for-foreign-authorities)

Çdo pyetje lidhur me këtë publikim duhet të na dërgohet në adresën UKCAStrategyandBusinessSupport@homeoffice.gov.uk

Përmbajtja

Pjesa 1 - Prezantimi me Ndhmën e Ndërsjellë Juridike në Mbretërinë e Bashkuar	7
Çfarë është Ndhma e Ndërsjellë Juridike?	7
Roli i autoriteteve qendrore në Mbretërinë e Bashkuar	8
Juridiksionet në varësinë e Kurorës dhe Territoret e Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar	8
Llojet e Ndhmës	9
Marrëveshjet dhe Organizimet Ndërkombëtare	9
Reciprociteti	9
Konfidencialiteti	9
Kolaterali ose Përdorimi i Mëtejshëm-Kërkesat e bëra nga Mbretëria e Bashkuar	10
Kolaterali ose Përdorimi i Mëtejshëm – Kërkesat që i bëhen Mbretërisë së Bashkuar	10
Bashkëpunimi nga Autoriteti i Zbatimit të Ligjit (Policia)	11
Rrjeti Gjyqësor Evropian në Çështjet Penale	12
Çështjet Civile	12
Dhënia e Dokumenteve në Çështjet Civile	13
Rrjeti Gjyqësor Evropian në Çështjet Civile dhe Tregtare	14
Pjesa 2 - Si të bëni një Kërkesë për Ndhmë të Ndërsjellë Juridike	15
A është MLA e Përshtatshme?	15
Kush mund të dërgojë një Kërkesë për MLA?	15
Ku duhet ta dërgoni një Kërkesë për MLA?	15
Informacioni që duhet të përfshihet në një Kërkesë për MLA	16
Kërkesat Urgjente	19
Pyetjet rreth Kërkesave Aktive	20
Njoftim kur Ndhma Nuk Është Më e Nevojshme	20
Kërkesat Plotësuese dhe Të Lidhura	20
Kërkesat De Minimis	20
Kriminalitet i Dyfishtë	21
Kostoja për Ekzekutimin e Kërkesave	21
Refuzimi i Kërkesave për MLA	22

Kjo pjesë jep në detaje format e ndihmës që Mbretëria e Bashkuar mund të japë dhe informacionin specifik që duhet të përfshihet në kërkesat për MLA. Kjo është përveç informacionit të kërkuar për të gjitha kërkesat për MLA siç përshkruhet në Pjesën 2. 24

Kryerja e Procesit – Transmetimi i Drejtpërdrejtë	24
Kryerja nëpërmjet një Autoriteti Qendror	24
Deklaratat dhe Intervistat	25
Kontaktimi i personave në Mbretërinë e Bashkuar	26
Dëshmia nën Betim/në Gjykatë	27
Privilegji	28
Seancat dëgjimore përmes Konferencës me Video apo me Telefon	28
Video Konferencë (Lidhje Televizive)	29
Konferenca me Telefon	30
Kontrolli dhe Sekuestrimi	30
Sekuestrimi i Kompjuterëve dhe Vend-ruajtjeve të tjera të Medias	32
Kërkesat për Kontroll dhe Konfiskim në Skoci	33
Urdhrat për Dorëzimin e Provave	33
Urdhrat për Dorëzimin e Provave: Procesi në Angli & Uells dhe Irlandën e Veriut	33
Urdhrat për Dorëzimin e Provave: Procesi Në Skoci	34
Provat Bankare	34
Kriptomonedha	35
Urdhra për Monitorimin e Llogarisë	36
Komunikimet dhe të Dhënat e Përmbajtjes	37
Përmbajtja e Komunikimit	37
Të dhënat e Komunikimit	37
Kërkesat për Ruajtjen e të Dhënave të Komunikimit	38
Ruajtja dhe mbrojtja e të dhënave të paqëndrueshme ndërkohë që përgatitet procesi ligjor	39
Si të bëni një kërkesë për ruajtjen e të dhënave	39
Përgjimi i Drejtpërdrejtë i Komunikimeve	40
Informacion për pasaportën dhe Statusin e Imigracionit	41
Të Dhënat e Regjistruara e Kompanisë	41
Gjendja Gjyqësore	42

Kërkesat nga Shtetet Anëtare të BE-së	42
Kërkesat nga Shtetet që nuk janë Anëtare të BE-së	43
Të Dhënat Gjyqësore	43
Vërtetimet e Gjykatës	43
Transkriptimi i Gjykimit / Arsytimi i Dënimit të dhënë	44
Procesi në Angli, Uells dhe Irlandën e Veriut	45
Procesi në Skoci	45
Transferimi i përkohshëm i një të Burgosuri për Qëllime të Hetimit	46
Procesi në Angli dhe Uells	47
Procesi në Irlandën e Veriut	47
Procesi në Skoci	47
Transferimi i të Burgosurve me Qëllim të Vuajtjes së Pjesës së Mbetur të Dënimit me Burg (<i>Transferimi i të Burgosurve që nuk i nënshtrohen MLA</i>)	48
Mostrat intime/jo-intime (përfshirë ADN-në)	49
ADN	49
Shenjat e gishtave	49
Oficerët e huaj në Mbretërinë e Bashkuar	50
Njoftim për Mbretërinë e Bashkuar për oficerët e zbatimit të ligjit që udhëtojnë në Mbretërinë e Bashkuar	50
Transferimi i Procedimeve	51
Transferimi i Raportimeve të Krimit	52
Shkëmbimi Spontan i informacionit	52
Europol ose Eurojust	53
Mashtrimi	53
Ekipet e Përbashkëta të Hetimit	53

Pjesa 4 - Rikuperimi i Aseteve dhe Hetimet Financiare	55
Gjurmimi i Aseteve	55
Ngrirja (Kufizimi) në Procedimet Penale	56
Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian - Kërkesat për Ngrirjen e Aseteve	60
Konfiskimi dhe Humbja në Procedimet Penale	60
Asgjësimi i Aseteve	62
Konfiskimi i Instrumenteve të Krimit	62

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian - Kërkesat për Konfiskim	63
Kërkesat për rikuperim pa gjykim	63
Pjesa 5 - Fjalorthi	66

Pjesa 1 - Prezantimi me Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Mbretërinë e Bashkuar

Çfarë është Ndihma e Ndërsjellë Juridike?

Ndihma e Ndërsjellë Juridike (MLA) është një metodë e bashkëpunimit ndërmjet Shteteve për të marrë ndihmë për hetimin ose ndjekjen penale të veprave penale. Zakonisht MLA përdoret për të marrë materiale të cilat nuk mund të merren duke u bazuar nga një autoritet për zbatimin e ligjit tek një autoritet për zbatimin e ligjit (shih **Pjesën 3** për më shumë detaje), veçanërisht për hetimet që kërkojnë masa shtrënguese. Kërkesat bëhen nëpërmjet një Letër-Porosi Ndërkombëtare në formë zyrtare (ILOR ose LOR), e njohur gjithashtu si *Kërkesë Zyrtare* në juridiksionet e së drejtës civile. Kjo ndihmë zakonisht kërkohet nga gjykatat apo prokurorët dhe për këtë arsye quhet gjithashtu “bashkëpunim gjyqësor”.

MLA mund të përdoret gjithashtu për të marrë ndihmë në lidhje me ngrirjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe hetimeve të lidhura me to (shih **Pjesën 4** për më shumë detaje). Çështjet e produkteve të krimit mund të jenë mbi bazën penale (dënimin) ose mbi një bazë civile (jo dënimi).

Për shkak të natyrës gjithnjë e më globale të krimit, Ndihma e Ndërsjellë Juridike është një mjet vendimtar për të mbështetur hetimet dhe procedimet penale si në MB ashtu edhe në juridiksione të tjera. Mbretëria e Bashkuar është e përkushtuar të ndihmojë autoritetet hetuese, të prokurorisë dhe gjyqësore në luftën kundër krimit ndërkombëtar dhe mund të ofrojë një gamë të gjerë të MLA-së. Siç u përmend më sipër, MLA është gjithashtu një mjet kritik në ndjekjen e financave kriminale. Këtu përfshihet rikuperimi i produkteve nga krimi të cilat mund të jenë transferuar dhe asetet e fshehura jashtë vendit.

Këto udhëzime synojnë të shërbejnë si një udhëzues për Shtetet për t'u siguruar që kërkesat për MLA të cilat merren nga MB të përmbajnë informacion të mjaftueshëm për çështjen konkrete në mënyrë që ato të pranohen dhe ekzekutohen shpejt dhe me efikasitet. Udhëzimet përfshijnë seksionet mbi:

- Udhëzime për autoritetet që dëshirojnë të bëjnë një **kërkesë zyrtare për MLA** drejtuar Mbretërisë së Bashkuar ("autoritetet kërkuuese"), në lidhje me Dorëzimin e Akteve Procedurale, Transferimin e Procedimeve dhe Kufizimin e Tjetërsimit dhe Konfiskimin e pasurisë.
- Udhëzime për autoritetet se çfarë informacioni ose ndihme mund të merret në Mbretërinë e Bashkuar **pa** pasur nevojë të bëjë një kërkesë zyrtare për MLA-në.

Roli i autoriteteve qendrore në Mbretërinë e Bashkuar

Autoritetet qendrore kanë funksionin e marrjes, pranimin dhe sigurimit të ekzekutimit të kërkesave të MLA-së. Të gjitha kërkesat e MLA për Mbretërinë e Bashkuar **duhet** të dërgohen tek një autoriteti qendror për shqyrtim. Mbretëria e Bashkuar ka tri autoritete qendrore me përgjegjësi të veçanta si më poshtë:

- Zyra e Brendshme **Autoriteti Qendror i Mbretërinë së Bashkuar** ('UKCA') për kërkesat e MLA në Angli, Uells dhe Irlandën e Veriut, **duke përjashtuar** hetimet që kanë të bëjnë vetëm me çështjet tatimore dhe doganore fiskale.
- **Zyra e të Ardhurave dhe Doganat e Madhërisë së Tij** ("HMRC") për kërkesat për MLA në Angli, Uells dhe Irlandën e Veriut vetëm në lidhje me çështjet e taksave dhe doganat fiskale, për shembull, mbledhja dhe menaxhimi i të ardhurave, pagesa e kredive tatimore.
- **Zyra e Kurorës** për kërkesat e MLA-së në lidhje me ndihmën në Skoci (duke përfshirë çështjet e taksave të decentralizuara Skoceze).

Të dhënat e kontaktit për të gjitha autoritetet përkatëse në Mbretërinë e Bashkuar mund të gjenden [këtu](#).

Juridiksionet në varësinë e Kurorës dhe Territoret e Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar

Juridiksionet në Varësinë e Kurorës (Bailiwicks e Guernsey, Jersey, dhe Isle of Man), dhe Territoret Britanike të Jashtme (Anguilla, Bermuda, British Virgin Islands, Cayman Islands, Falklands, Gibraltar, Montserrat, St Helena, Turks dhe Caicos Islands, dhe Pitcairn) nuk janë pjesë e Mbretërisë së Bashkuar.

Juridiksionet në Varësinë e Kurorës dhe Territoret e Jashtme janë plotësisht përgjegjëse për ekzekutimin e kërkesave brenda juridiksioneve të tyre.

Juridiksionet në Varësinë e Kurorës dhe Territoret Britanike të Jashtme kanë secili sistemet e tyre ligjore, të pavarura nga Mbretëria e Bashkuar. Kërkesat për MLA për Juridiksionet në Varësinë e Kurorës ose Territoret Britanike të Jashtme duhet t'i dërgohen Prokurorit të Përgjithshëm përkatës, ose ekuivalentit të tij. Të dhënat e kontaktit për shumë nga këto juridiksione mund të gjenden [këtu](#).

Kërkesat për inteligjencë, nëpërmjet Interpol, nga Juridiksionet në Varësinë e Kurorës, Falklands dhe St Helena duhet të dorëzohen nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Krimit të Mbretërisë së Bashkuar (NCA) në adresën e postës elektronike: manchester@nca.gov.uk.

Territoret e tjera të Jashtme kanë zyrat e tyre të veta të Interpol-it dhe për këtë arsye kërkesat për inteligjencë për ato territore duhet të dorëzohen drejtpërdrejt.

Llojet e Ndihmës

Ekziston një gamë e gjerë e MLA-së që mund të sigurohet nga Mbretëria e Bashkuar e kushtëzuar nga plotësimi i kriterëve në mënyrë të saktë. Ju lutemi referojuni **Pjesës 3** të udhëzimeve për informacion në lidhje me llojet më të zakonshme të MLA-së.

Në disa raste, provat mund të merren nëpërmjet **bashkëpunimit ndërmjet autoritetit të zbatimit të ligjit me autoritetin e zbatimit të ligjit** ose duke e kërkuar atë në mënyrë vullnetare pa ndihmën zyrtare nga një autoritet qendror i Mbretërisë së Bashkuar. Kur një bashkëpunim i tillë është i disponueshëm për një masë specifike, kjo është theksuar në **Pjesën 3**.

Marrëveshjet dhe Organizimet Ndërkombëtare

Mbretëria e Bashkuar është palë në disa traktate dypalëshe dhe shumëpalëshe për MLA-në (shih këtë [lidhje](#) për një listë të marrëveshjeve ndërkombëtare ku Mbretëria e Bashkuar është palë).

Mbretëria e Bashkuar mund të japë MLA për çdo shtet ose territor në botë, pavarësisht nëse ai shtet është në gjendje ta ndihmojë Mbretërinë e Bashkuar apo jo dhe nëse ekziston ose jo një marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe.

Kur një marrëveshje imponon kushte ose procedura specifike, Mbretëria e Bashkuar pret që ato të respektohen në mënyrë që të sigurohet një përgjigje ndaj kërkesës për ndihmë.

Kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian (EUMS) duhet të bëhen duke iu referuar [Konventës Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale 1959](#) të Këshillit të Evropës, dhe protokolleve shtesë të saj, të plotësuara nga [Marrëveshja e Tregtisë dhe e Bashkëpunimit BE-MB](#). Kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike nga Shtetet Anëtare të BE-së duhet të bëhen duke përdorur Formularin Standard për kërkesat për Ndihmë të Ndërsjellë.

Reciprociteti

Mbretëria e Bashkuar në përgjithësi nuk kërkon reciprocitet, por do të priste ndihmë nga shtetet që janë palë në marrëveshjet përkatëse dypalëshe ose ndërkombëtare me Mbretërinë e Bashkuar. Mbretëria e Bashkuar gjithashtu do të priste reciprocitet nga shtetet të cilave u japim ndihmë pa pasur një traktat ose një marrëveshje ndërkombëtare. Reciprociteti kërkohet për të gjitha kërkesat për ndihmë në çështjet tatimore.

Konfidencialiteti

Politika standarde për autoritetet qendrore ose ekzekutuese është që as të konfirmojnë dhe as të mohojnë ekzistencën e një kërkesë për MLA dhe të mos zbulojnë asgjë nga

përmbajtja e tyre jashtë departamenteve qeveritare, agjencive qeveritare, gjykatave ose agjencive të zbatimit të ligjit në Mbretërinë e Bashkuar pa pëlqimin e autoritetit kërkues.

Kur bëhen deklaratat publike nga një autoritet jashtë shtetit në lidhje me ndihmën që po kërkon nga Mbretëria e Bashkuar, autoriteti qendror duhet të njoftohet në mënyrë që ata të mundën të përgjigjen në mënyrë të përshtatshme ndaj çdo media ose kërkesë publike.

Në përgjithësi, kërkesat nuk u tregohen ose kopjohen për ndonjë dëshmitar ose person tjetër, dhe asnjë dëshmitar nuk informohet mbi identitetin e ndonjë dëshmitari tjetër. Disa zbulime mund të jenë të nevojshme për ekzekutimin e një kërkesë për MLA (për shembull konfirmimi për ekzistencën e kërkesës për një dëshmitar ku të shpjegohet qëllimi i marrjes së një deklarate). Nëse kërkesat e konfidencialitetit për një kërkesë për MLA e bëjnë ekzekutimin e një kërkesë të vështirë ose të pamundur, autoriteti qendror do të konsultohet me autoritetin kërkues. Në rastet kur zbulimi i një kërkesë, ose të një pjese të një kërkesë, kërkohet nga ligji i brendshëm i Mbretërisë së Bashkuar për të ekzekutuar kërkesën, normalisht do të ndodhë që autoritetit kërkues t'i jepet mundësia për ta tërhequr kërkesën, përpara se të bëhet ndonjë zbulim tek një palë e tretë.

Kolaterali ose Përdorimi i Mëtejshëm-Kërkesat e bëra nga Mbretëria e Bashkuar

Evidencat e marra **nga Mbretëria e Bashkuar** në përputhje me një kërkesë për MLA të bërë një autoriteti jashtë shtetit nuk do të përdoren për ndonjë qëllim tjetër përveç atij të përcaktuar në kërkesën origjinale pa marrë pëlqimin e autoritetit përkatës (shih [seksioni 9 \(2\)](#) i Ligjit për Krimin (Bashkëpunimi Ndërkombëtar) 2003 ('CICA') dhe gjithashtu vendimin e Gjykatës së Apelit për [Shërbimi i Prokurorisë së Kurorës & Anor kundër Gohil \[2012\]](#)).

Kolaterali ose Përdorimi i Mëtejshëm – Kërkesat që i bëhen Mbretërisë së Bashkuar

Kur një autoritet kërkues dëshiron të përdorë provat e marra **nga Mbretëria e Bashkuar** për një qëllim të ndryshëm nga ai i deklaruar në kërkesën origjinale për MLA, ose për t'i ndarë provat ose çdo të dhënë personale që është dhënë me një shtet të tretë, për ta bërë këtë duhet të bëhet një kërkesë zyrtare me shkrim nga shteti kërkues origjinal tek autoriteti qendror përkatës në Mbretërinë e Bashkuar dhe ajo duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

Kërkesë për përdorimin e Evidencave për Qëllime të Tjera:

- Numrin e referencës të autoritetit qendror në lidhje me kërkesën origjinale.
- Cilat evidenca duhet të përdoren/ndahen.
- Si do të përdoren/ndahen ato evidenca.

- Përse nevojiten ato evidenca në këto hetime/procedime gjyqësore të reja/të tjera.
- Nëse hetimi/procedimi gjyqësor është i natyrës penale.
- Citoni çdo dispozitë të traktateve shumëpalëshe ose dypalëshe, ose të marrëveshjeve të tjera, në lidhje me përdorimin e kolateralit, nëse është rasti.

Ju lutemi vini re se lista e mësipërme nuk është shteruese. Autoriteti qendror mund të kërkojë detaje të mëtejshme ashtu siç mund kërkohet nga rrethanat.

Bashkëpunimi nga Autoriteti i Zbatimit të Ligjit (Policia)

Një bashkëpunim i tillë lidhet me policinë, ose agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, të një shteti kërkues i cili kërkon ndihmën e policisë ose agjencive të zbatimit të ligjit në Mbretërinë e Bashkuar për të mbledhur informacion për një hetim. Ndonjëherë kjo mund të jetë një mënyrë më e lehtë dhe më e shpejtë për të marrë inteligjencë dhe, atëherë kur është e zbatueshme, evidenca, pasi nuk ka nevojë për një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë juridike.

Bashkëpunimi ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit gjithashtu mund të informojë më mirë hartimin e një kërkesë për MLA në rast se bëhet një e tillë më vonë.

Në çështjet e rikuperimit të aseteve, është thelbësore që gjurmimi i aseteve të kryhet përmes bashkëpunimit ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit pasi kjo nuk mund të bëhet përmes ndihmës së ndërsjellë ligjore (informacione të mëtejshme për kërkesat për rikuperimin e aseteve mund të gjenden në **Pjesën 4** të këtij udhëzimi).

Në sistemet ligjore të shumë vendeve, informacioni i mbledhur nga agjencitë e zbatimit të ligjit në Mbretërinë e Bashkuar është i pranueshëm drejtpërdrejt si evidencë në procedimet penale me lejen e agjencive të zbatimit të ligjit të Mbretërisë së Bashkuar. Për shembull, vendet që, sipas ligjit të tyre të brendshëm, nuk kërkojnë që për dëshminë të betohet një dëshmitar, një i dyshuar ose një viktimë në një gjykatë mund të konsiderojnë përdorimin e bashkëpunimit ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit për të kërkuar që informacioni të përdoret si evidencë.

Në rast se kontakti i drejtpërdrejtë midis një force policore jashtë shtetit dhe një force policore në Mbretërinë e Bashkuar nuk është vendosur tashmë, duhet të kontaktohet NCA për kërkesën. NCA vepron si porta e Interpol-it e Mbretërisë së Bashkuar për të gjitha hetimet e policisë që vijnë ose dërgohen. NCA do t'i përcjellë kërkesat përmes rrjetit të Interpol-it tek forca përkatëse e policisë ose tek agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit që më pas do të ekzekutojë kërkesën, në varësi të çdo marrëveshjeje për ndarjen e të dhënave.

Informacione të mëtejshme mbi përdorimin e bashkëpunimit ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit gjenden në GOV.UK

Agjencitë e mëposhtme të zbatimit të ligjit në Mbretërinë e Bashkuar mund t'i marrin kërkesat direkt nga oficerët e zbatimit të ligjit në juridiksione të ndryshme (në disa raste kjo do t'i nënshtrohet një marrëveshjeje për ndarjen e të dhënave ose memorandumit të mirëkuptimit):

- Zyra e Ndërlidhjes e Mbretërisë së Bashkuar në Europol, përmes NCA.
- Interpol-i përmes NCA.
- Zyra e Brendshme (duke përfshirë Forcën Kufitare të Mbretërisë së Bashkuar dhe Zbatimin e Ligjit për Imigracionin).
- HMRC.
- Shërbimet e Policisë.
- Njësitë e Inteligjencës Financiare.
- [Qendra Ndërkombëtare e Koordinimit Kundër Korrupsionit](#) (për rastet e mëdha të korrupsionit).

Rrjeti Gjyqësor Evropian në Çështjet Penale

Rrjeti Gjyqësor Evropian (EJN) është një rrjet i pikave kombëtare të kontaktit për lehtësimin e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale. Detajet rreth rrjetit, si dhe informacione të dobishme mbi bashkëpunimin gjyqësor, duke përfshirë sistemet dhe mjetet kombëtare, janë në dispozicion në [Rrjeti Gjyqësor Evropian \(EJN\) \(europa.eu\)](#).

Çështjet Civile

Ju lutemi vini re se kërkesat e MLA-së në Mbretërinë e Bashkuar në lidhje me çështjet civile trajtohen nga autoritete të ndryshme nga ato që merren me kërkesat e MLA-së për çështjet penale.

Kërkesat e MLA-së për dhe nga Mbretëria e Bashkuar në lidhje me çështjet civile trajtohen në përputhje me [Rregullat e Procedurës Civile Pjesa 34](#), dhe më vete nga kërkesat penale. Marrja e evidencave nga juridiksione të tjera në lidhje me mosmarrëveshjet civile (të cilat përfshijnë mosmarrëveshjet tregtare) përfshihet në [Ligjin për Evidencat 1975 \(Procedimet në Juridiksionet e Tjera\) 1975](#).

Ndërkombëtarisht, Konventat e ndryshme të Hagës përcaktojnë procedurat për rregullimin e çështjeve civile. Lidhja për faqet e Mbretërisë së Bashkuar është [këtu](#).

Dhënia e Dokumenteve në Çështjet Civile

Angli, Uells dhe Irlanda e Veriut

Agjencia transmetuese mund t'i dërgojë dokumentet që do të jepen direkt në Gjykatën Mbretërore të Drejtësisë (RCJ), pas procesit të përshkruar më poshtë. Megjithatë, nëse dokumentet dërgohen përmes Zyrës së Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit (FCDO) atëherë FCDO do të bëhej agjencia që i transmeton:

- Plotësoni një formular të Kërkesës së Hagës, i cili gjendet [këtu](#), ju lutemi vini re se RCJ kërkon dy formularë kërkesë të plotësuar plotësisht për secilin komplet dokumentesh.
- Përfshini dy komplete dokumentesh, një komplet për t'u dhënë dhe kompleti tjetër për kthim.
- Jepini dokumentet në kopje fizike (Cd ose USB ose çdo format tjetër që nuk është në letër nuk mund të jepet).
- Të gjitha dokumentet, përfshirë formularin e kërkesës, duhet të përkthehen në anglisht.
- Nuk ka asnjë tarifë për shërbimin, përveç kostos së postimit.

RCJ do të dërgojë një certifikatë të dorëzimit ose të mos-dorëzimit tek agjencia përkatëse transmetuese.

Kërkesat për Dorëzimin e Dokumenteve në Çështjet Civile Ndërkombëtare	Kërkesat për Dorëzimin e Dokumenteve dhe Marrjen e Dëshmime në Çështjet Civile
Premium Service Legalisation Office Foreign, Commonwealth & Development Office King Charles Street (Sanctuary Buildings) London SW1A 2AH	Royal Courts of Justice Group Queen's Bench Division Foreign Process Section Room E16 Royal Courts of Justice Strand London WC2A 2LL
Telefon: +44 20 7008 4126	Telefon: +44 20 3936 8957
Email: SOPEnquiries@fcdo.gov.uk	Email: foreignprocess.rcj@justice.gov.uk

Skoci

Kërkesat për Dorëzimin e Dokumenteve në Çështjet Civile Ndërkombëtare

The Central Authority & International Law Team
Scottish Government
Justice Directorate
St Andrew's House
Regent Road
Edinburgh
EH1 3DG

Rrjeti Gjyqësor Evropian në Çështjet Civile dhe Tregtare

Ekziston një [faqe interneti](#) e Rrjetit Gjyqësor Evropian (EJN) për Çështjet Civile dhe Tregtare ku mund të gjendet një sasi e madhe informacioni mbi Shtetet Anëtare të BE-së, ligjin e Komunitetit, ligjin Evropian dhe aspekte të ndryshme të së drejtës civile dhe tregtare.

Pjesa 2 - Si të bëni një Kërkesë për Ndhimë të Ndërsjellë Juridike

A është MLA e Përshtatshme?

Në disa raste, një kërkesë për MLA mund të mos jetë e përshtatshme sepse:

- Materiali mund të merret **vullnetarisht ose me burim të hapur** pa ndonjë ndihmë nga autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar (edhe pse agjencitë e zbatimit të ligjit në Mbretërinë e Bashkuar duhet të njoftohen).
- Materiali mund të merret nëpërmjet **bashkëpunimit të agjencisë së zbatimit të ligjit me agjencinë e zbatimit të ligjit** (shih **Pjesën 1** e këtyre udhëzimeve) dhe ai kërkohet vetëm për qëllimet e inteligjencës, ose materiali i marrë në këtë mënyrë është i pranueshëm si provë në juridiksionin e autoritetit kërkues.

Shpesh është e dëshirueshme që autoritetet jashtë shtetit të **marrin inteligjencë** përpara se të bëjnë një kërkesë për MLA-në, nëpërmjet bashkëpunimit të agjencisë së zbatimit të ligjit me agjencinë e zbatimit të ligjit. Kjo mund të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së kërkesës për MLA-në dhe e bën më pak të mundshme që një kërkesë t'i kthehet autoritetit kërkues për mungesë informacioni.

Kërkesat për ndihmë në **çështjet civile** trajtohen nga një proces tjetër, siç shpjegohet në **Pjesën 1** të këtyre udhëzimeve.

Kush mund të dërgojë një Kërkesë për MLA?

Çdo organ kompetent sipas ligjit të vendit kërkues mund të lëshojë një kërkesë për Mbretërinë e Bashkuar. Këtu përfshihen gjykata që ushtron juridiksion penal ose një autoritet i prokurorisë jashtë Mbretërisë së Bashkuar.

Ku duhet ta dërgoni një Kërkesë për MLA?

Kërkesat për MLA duhet të dërgohen tek [autoriteti qendror përkatës](#).

Kërkesat që nuk janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara më poshtë mund t'i kthehen autoritetit kërkues dhe mund të mos ekzekutohen.

Kërkesat për Autoritetin Qendror të Mbretërisë së Bashkuar tani mund të dorëzohen nëpërmjet shërbimit të ri në internet, i cili mund të përdoret nëpërmjet faqeve të Gov.uk për MLA-të. Detaje të mëtejshme gjenden më poshtë.

Informacioni që duhet të përfshihet në një Kërkesë për MLA

Ju lutemi vini re se kur ekziston një marrëveshje me një vend kërkues e cila përcakton që duhet të përdoret një formular standard, kërkesat për MLA duhet të përmbahen [në formularin përkatës ku secili seksion të plotësohet plotësisht sipas rastit](#).

Në rast se nuk ka asnjë kërkesë për përdorimin e një formulari standard, UKCA megjithatë rekomandon që kërkesat të bëhen duke përdorur shembullin e modeleve të kërkesave në [faqen e internetit](#) për MLA-të.

Kur nuk është përdorur një model standard, një Letër Porosi duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm. Ky është përtej informacionit të kërkuar për llojin specifik të ndihmës së kërkuar, detajet e të cilit përshkruhen në **Pjesën 3**:

Letra e prezantimit	Datat përkatëse p.sh. data e seancës gjyqësore (arsyeja e urgjencës ose vëmendjes së veçantë duhet të përfshihen në letrën e prezantimit të kërkesës).
Koka e Letrës ose Koka Zyrtare e Letrës	Ju lutemi sigurohuni që letra juaj e kërkesës të ketë kokën zyrtare të letrës së autoritetit lëshues dhe të nënshkruhet.
Përkthimi në Anglisht	Për kërkesat që nuk janë bërë në gjuhën angleze: ju lutemi jepni një version të nënshkruar të kërkesës që nuk është në anglisht <i>dhe</i> një përkthim të kërkesës në anglisht.
Të Dhënat e Autoritetit Lëshues	Përfshini emrin e autoritetit (përfshirë kompetencat e brendshme që ka ai autoritet për të lëshuar një kërkesë) dhe personin që bën kërkesën, adresën e kontaktit, numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike.
Kërkesat e Mëparshme	Aty ku është e aplikueshme, ju lutemi përfshini numrat e referencës ose emrat e çështjeve të çdo kërkesë të mëparshme që është dërguar në MB të cilat janë të lidhura me kërkesën që po dërgohet.
Baza Ligjore e kërkesës	Ju lutemi tregoni qartë nëse kërkesa është bërë në bazë të një traktati, konvente dypalëshe apo shumëpalëshe ose mbi bazën e reciprocitetit (ju lutemi shikoni këtë lidhje për konventat dhe traktatet në të cilat Mbretëria e Bashkuar është palë).
Kopje e Legjislacionit	Ajo duhet të jetë vetëm për seksionin(et) përkatës i cili detajon veprën penale dhe veprimtarinë kriminale nën hetim, duke përfshirë dënimet e lidhura me veprën(at) penale dhe të drejtat që mund t'i jepen një personi.

Interesi i medias / Profili i Lartë / Çështjet e Ndjeshme	Nëse është e aplikueshme, ju lutemi jepni detaje për çdo vëmendje mediatike, ndjeshmërie ose arsye të interesit të profilit të lartë për çështjen.
Datat e rëndësishme	Kur kërkon prova që mbulojnë një periudhë të caktuar kohore, ju lutemi sigurohuni që diapazoni i datave të kërkuara të jetë i justifikuar. Datat duhet të pasqyrojnë veprimtarinë kriminale të hetimit, kërkesat nuk duhet të jenë të përgjithshme.
Të dyshuarit/Personi i Interesit	Në rastet kur dihen, detajet e plota të të dyshuarve nën hetim dhe/ose të çdo personi me interes. Ju lutemi përfshini, nëse dihen, emrin e plotë, datën e lindjes, adresën, shtetësinë dhe numrat e çdo pasaporte ose karte identiteti. Përfshini detaje të lidhjes së tyre me Mbretërinë e Bashkuar dhe çdo kontakt ose detaj personal, duke përfshirë, kur është në dispozicion, adresën/vendndodhjen, datën e lindjes dhe shtetësinë (<i>nëse janë konfidenciale ato mund të dërgohen veçmas kërkesës</i>). Ju lutemi tregoni nëse ndonjë person që i është dhënë emri në kërkesë është dëshmitar, i dyshuar, i pandehur ose viktimë.
Përmbledhja e fakteve	Jepni një përmbledhje të fakteve të çështjes nën hetim. Ju lutemi përfshini: kur ka filluar hetimi, detajet e çdo inteligjence të marrë dhe nga ku janë marrë, detajet e përfshirjes së të dyshuarve dhe veprimtarisë së tyre kriminale. Ju lutemi përfshini: datat kur ka ndodhur veprimtaria kriminale dhe detajet e lidhjes ndërmjet hetimit dhe Mbretërisë së Bashkuar. Ju lutemi tregoni qartë lidhjen ndërmjet provave të kërkuara dhe veprës penale nën hetim ose procedimit (d.m.th. pse janë të nevojshme provat). Duhet të përcaktohet një <i>lidhje</i> e qartë. Kjo shkon përtej sesa thjesht deklarimit se materiali i kërkuar është i rëndësishëm për çështjen. Ju lutemi vini re se ne nuk kërkojmë dosjet e plota të

	çështjes ose kopje të të gjitha provave të marra në një hetim.
Lloji i ndihmës së kërkuar	Renditni masat që po kërkon. Shpjegoni se çfarë provash dëshironi të merrni, ku ndodhet ajo provë dhe detaje se pse ajo mund të merret vetëm nga MB.
Detajet e çdo hetimi para-MLA-së	Ju lutemi përfshini të dhënat e çdo kërkimi të bërë tek agjencitë e zbatimit e ligjit ose shërbimet e inteligjencës në Mbretërinë e Bashkuar, duke dhënë çdo detaj të kontaktit në Mbretërinë e Bashkuar nëse është i disponueshëm.
Çështjet Urgjente	Në rast se është e aplikueshme, ju lutemi jepni detaje se pse kërkesa kategorizohet si urgjente për shembull: • dikush po mbahet në paraburgim. • dikush pritet të lirohet nga paraburgimi. • paraqitjet në gjykatë para gjyqit ose datat e gjyqit. • ekziston një rrezik i menjëhershëm ndaj individëve. • rreziku i shpërndarjes së aseteve etj. dhe jepni datat e çdo afati i cili duhet të respektohet.

Mosdhënia e informacionit sa më të plotë të mundshëm mund të rezultojë në vonesa ose që kërkesa të mos ekzekutohet në tërësi ose pjesërisht. Ju lutemi vini re se kërkesat për formalitetet e tilla si certifikimi apo vërtetimi do të merren parasysht dhe do të respektohen në masën e lejuar sipas ligjit të brendshëm.

Transmetimi

Kërkesat duhet të bëhen gjithmonë me shkrim. Për Autoritetin Qendror të Mbretërisë së Bashkuar, kërkesat tani duhet të dorëzohen online nëpërmjet shërbimit Online për Dorëzimin e Formularit të Kërkesës për MLA në Gov.uk. Në rast se shtetet kërkuese nuk janë në gjendje t'i paraqesin kërkesat e tyre online, metodat tradicionale (me email ose me postë) janë ende të pranueshme.

Shërbimi Online për Dorëzimin e Formularit:

- Është një shërbim i sigurt i Zyrës së Brendshme i cili mund të përdoret përmes faqes së Gov.uk për MLA-në: [Ndihma e ndërsjellë juridike - GOV.UK \(www.gov.uk\)](https://www.gov.uk)
- Ai ofron një metodë të dorëzimit të menjëhershëm për shtetet kërkuese që të dërgojnë të gjitha kërkesat për MLA tek Autoriteti Qendror i Mbretërisë së Bashkuar, zvogëlon kohën e përpunimit dhe të përgjigjes dhe synon të përmirësojë saktësinë dhe cilësinë e informacionit të dorëzuar përmes validimit të të dhënave.

- Nuk përdor një entitet tregtar për trajtimin ose përpunimin e të dhënave tuaja dhe është metoda më e sigurt e dorëzimit (kur krahasohet me postën elektronike ose rrugët postare).

Mbretëria e Bashkuar nuk kërkon që kërkesat të vijnë përmes kanaleve diplomatike dhe autoritetet qendrore janë dakord t'i marrin kërkesa drejtpërdrejt. Megjithatë, autoriteti kërkues do të duhet të respektojë ligjet e veta të brendshme në lidhje me transmetimin e kërkesave.

Dokumentet procedurale mund të dorëzohen për individët e prekur direkt me postë. Ju lutemi shihni detajet e mëtejshme në lidhje me këtë në **Pjesën 3**.

Ju lutemi mos dërgoni asnjë imazh të pahijshëm ose prova origjinale tek UKCA ose tek autoritetet e tjera qendrore të Mbretërisë së Bashkuar. Shteti kërkues do të këshillohet mbi mënyrën se si duhet të dërgohet një material i tillë pasi kërkesa për MLA-në të jetë shqyrtuar dhe referuar tek një autoritet ekzekutues.

Afatet kohore

Aty ku baza e traktatit i përcakton afatet kohore, do të zbatohen afatet kohore standarde përveç rasteve kur është deklaruar ndonjë urgjencë ose kur bihet dakord për një zgjatje të afateve.

Kërkesat Urgjente

Të gjitha autoritetet qendrore të Mbretërisë së Bashkuar do të shqyrtojnë çdo arsye të urgjencës që deklarohet në mënyrë të qartë në kërkesë.

Në rast se ju e vlerësoni se kërkesa juaj është urgjente, ju lutemi shënoni qartë me '**URGJENTE**' dhe shpjegoni qartë arsyet pse është kategorizuar si e tillë.

Arsyet e Mundshme për Urgjencën:

- Dikush po mbahet në paraburgim.
- Dikush pritët të lirohet nga paraburgimi.
- Janë në pritje për t'u paraqitur në gjykatë para gjyqit ose të datës së gjyqit.
- Ekziston një rrezik i menjëhershëm ndaj individëve (p.sh. janë të pranishme shqetësime mbi mbrojtjen e sigurisë).
- Kryerja e veprës penale është duke vazhduar.
- Ekziston rreziku i shpërndarjes së provave ose pasurive.

Pyetjet rreth Kërkesave Aktive

Pasi një autoritet qendror të ketë marrë një kërkesë për MLA, kërkesa do të regjistrohet dhe do t'i caktohet një numër referimi/protokolli.

Autoritetit kërkues do t'i shkruhet për t'i bërë të ditur të dhënat e kontaktit të ekipit që merret me çështjen e tyre. Çdo korrespondencë pasuese në lidhje me kërkesën për MLA-në duhet të citojë numrin e referencës së autoritetit qendror.

Njoftim kur Ndihma Nuk Është Më e Nevojshme

Në rast se ndihma e kërkuar nuk është më e nevojshme, autoriteti qendror duhet të informohet menjëherë, duke cituar numrin e referencës së autoritetit qendror.

Kërkesat Plotësuese dhe Të Lidhura

Kërkesat të cilat kanë të bëjnë me një kërkesë të mëparshme mund t'i dërgohen autoritetit qendror si kërkesë e lidhur ose plotësuese.

Informacioni që duhet të përfshihet në një Kërkesë Plotësuese dhe/ose që Lidhet me një tjetër:

- Një Deklaratë se kjo kërkesë është e lidhur me një kërkesë të mëparshme.
- Numrin e referencës të autoritetit qendror për kërkesën e mëparshme.
- Të gjithë informacionin që lidhet me një kërkesë standarde për MLA-në (shih më sipër), plus çdo informacion të mëtejshëm në lidhje me llojin specifik të kërkesës shtesë.

Kërkesat De Minimis

Autoritetet ekzekutuese të Mbretërisë së Bashkuar kanë në dispozicion burime publike të kufizuara, dhe *de minimis* kërkesat (e parëndësishme ose joproporcionale) për MLA mund të refuzohen nga Autoriteti Qendror i Mbretërisë së Bashkuar mbi këtë bazë nëse ato plotësojnë kriteret (ose kriteret e krahasueshme) të përcaktuara më poshtë:

- Ka pasur një humbje apo fitim financiar ose dëmtim prej **më pak se 1000 £**,

ose

- Vepra e dyshuar është kryer **më shumë se 10 vjet më parë** (dhe nuk ka asnjë shpjegim, ose ai është i pamjaftueshëm për vonesën në hetim ose ndjekje penale).

Kur merren parasysh kriteret e mësipërme që kanë të bëjnë me një kërkesë *de minimis*, merren parasysh edhe faktorët e mëposhtëm:

- Nëse ka ndonjë faktor rëndues.
- Nëse një autoritet i ndjekjes penale i Mbretërisë së Bashkuar do të dërgonte një kërkesë në rrethana të ngjashme.
- Nëse kërkesa është për një masë 'shtrënguese'.
- Nëse ka implikime të burimeve për ekzekutimin e autoriteteve.

Ju lutem vini re se politika për *de minimis* nuk zbatohet për kërkesat e bëra nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian sipas Konventës Evropiane për Ndihmën Reciproke në Çështjet Penale 1959 dhe protokolleve shtesë të saj, me shtesat në Marrëveshjen e Tregtisë dhe Bashkëpunimit BE-UK.

Zyra e Kurorës në Skoci dhe HMRC nuk e vënë në zbatim politikën për *de minimis*.

Kriminalitet i Dyfishtë

Mbretëria e Bashkuar në përgjithësi e kërkon kriminalitetin e dyfishtë vetëm për masat shtrënguese duke përfshirë urdhrat e kontrollit të konfiskimit dhe të dorëzimit të dokumenteve (duke përfshirë provat bankare) dhe kufizimin dhe konfiskimin. Ndiqet qasja e bazuar tek "*veprimtaria*", domethënë që veprimtaria që qëndron në themel të veprës së dyshuar merret parasysh kur vlerësohet kriminaliteti i dyfishtë, në vend që të kërkohej të përputhet me të njëjtën vepër penale ose kategori të veprave penale në të dyja juridiksionet.

Kostoja për Ekzekutimin e Kërkesave

Zakonisht Mbretëria e Bashkuar do të përmbushë kostot për ekzekutimin e një kërkesë, megjithatë ka përjashtime të cilat përfshijnë:

- Tarifat dhe shpenzimet e arsyeshme të **dëshmitarëve ekspertë**.
- Shpenzimet e **transferimit të personave në kujdestari**.
- Kostot e marrjes së **transkripteve të procedimeve** dhe arsyeve të gjyqtarit për dënimin e dhënë (shih Transkriptet e Gjyqit / Arsyet e Dënimit më poshtë).
- Kostot e një **natyre të jashtëzakonshme** për të cilat është rënë dakord me autoritetin kërkues (për to do të bihet dakord përpara se të kryhen shpenzimet).

- **Përkthimi dhe / ose transkriptimi** i procedimeve me lidhjet me video (në rast se kjo kërkohet).

Refuzimi i Kërkesave për MLA

Në praktikë, Mbretëria e Bashkuar e pranon shumicën e kërkesave të marra dhe ekziston një prezumim se MLA do të jepet aty ku janë përmbushur të gjitha kërkesat e masave hetimore sipas ligjit të Mbretërisë së Bashkuar. Megjithatë, autoritetet qendrore të Mbretërisë së Bashkuar ruajnë një diskrecion të gjerë kur shqyrtojnë nëse do të pranojnë një kërkesë.

Arsyet e Mundshme të Refuzimit përfshijnë:

- Kërkesa ka të bëjë me një hetim ose ndjekje penale e cila është e motivuar politikisht.
- Ekzekutimi i kërkesës do të paragjykonte sovranitetin, sigurinë ose interesat e tjera thelbësore të Mbretërisë së Bashkuar.
- Ekzekutimi i kërkesës do të paragjykonte *rendin publik* të Mbretërisë së Bashkuar (këtu përfshihet rreziku që të jepet dënimi me vdekje për krimin nën hetim).
- Gjykimi dy herë për të njëjtën vepër penale: Kërkesa ka të bëjë me një person i cili, nëse ndaj tij procedohet në Mbretërinë e Bashkuar për veprën penale për të cilën kërkohet ndihma, do të kishte të drejtën që t'i rrëzoheshin akuzat mbi bazën që më parë është gjetur i pafajshëm ose është dënuar. *(Ju lutem vini re: në Mbretërinë e Bashkuar përkufizimi për gjykimin e dyfishtë për të njëjtën vepër përfshin gjetjen fajtor ose të pafajshëm në çdo vend. Gjykimi i dyfishtë për të njëjtën vepër nuk zbatohet kur ka pasur një hetim të mëparshëm, por nuk janë ngritur akuza).*
- Kërkesa lidhet me një vepër penale të cilën Mbretëria e Bashkuar e konsideron si një vepër penale sipas ligjit ushtarak, e cila nuk është gjithashtu një vepër penale sipas ligjit penal të zakonshëm.
- Ekzistojnë arsye thelbësore për të besuar se kërkesa është bërë me qëllimin për të hetuar, ndjekur penalisht ose për të ndëshkuar një person për shkak të racës, gjinisë, orientimit seksual, fesë, kombësisë, origjinës etnike ose mendimeve politike të tij/saj ose se pozicionit i atij personi mund të paragjykohet për ndonjë prej këtyre arsyeve.
- Kërkesa është "De Minimis": Për shkak të natyrës së parëndësishme të veprës së dyshuar, vlerës së ulët apo kalimit të kohës që nga veprimtaria penale (shih më sipër).
- Kërkesa është për një masë shtrënguese apo ndërhyrëse për të cilën Mbretëria e Bashkuar kërkon kriminalitetin e dyfishtë dhe në lidhje me të cilën nuk ka vepër ekuivalente në Mbretërinë e Bashkuar (shih më sipër).

- Ndihma e kërkuar do të përmbajë të dhënat personale dhe dhënia e atyre të dhënave nuk është e mundur sipas legjislacionit të Mbretërisë së Bashkuar për mbrojtjen e të dhënave.

Mbretëria e Bashkuar kryen një vlerësim të të drejtave të njeriut kur vlerëson dhënien e ndihmës jashtë shtetit. Informacione të mëtejshme se si Mbretëria e Bashkuar i vlerëson çështjet e të drejtave të njeriut në kontekstin e ofrimit të ndihmës mund të gjenden në [Siguria & Ndihma Juridike Jashtë Shtetit](#) Udëzimi (OSJA).

Pjesa 3 – Llojet e Ndihmës

Kjo pjesë jep në detaje format e ndihmës që Mbretëria e Bashkuar mund të japë dhe informacionin specifik që duhet të përfshihet në kërkesat për MLA. Kjo është përveç informacionit të kërkuar për të gjitha kërkesat për MLA siç përshkruhet në **Pjesën 2**.

Kryerja e Procesit – Transmetimi i Drejtpërdrejtë

Dokumentet procedurale mund të dërgohen **drejtpërdrejt** nga autoriteti kërkues tek personat në Mbretërinë e Bashkuar me të cilët ata lidhen. Mbretëria e Bashkuar inkurajon fuqimisht transmetimin e drejtpërdrejtë me postë të dokumenteve procedurale tek personat, përveç rasteve kur kjo nuk është e mundur ligjërisht sipas ligjit të brendshëm të autoritetit kërkues.

Neni 16 i [protokolli i dytë shtesë](#) i Konventës Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë për Çështjet Penale 1959 parashikon që dokumentet procedurale dhe vendimet gjyqësore të postohen drejtpërdrejt.

Kryerja nëpërmjet një Autoriteti Qendror

Në përputhje me [seksionet 1 dhe 2](#) të Ligjit për Krimin (Bashkëpunimi Ndërkombëtar) 2003 ("CICA"), një kërkesë mund t'i bëhet Autoritetit Qendror të Mbretërisë së Bashkuar ose Zyrës së Kurorës për dhënien e dokumenteve procedurale (p.sh. një thirrje ose vendim gjyqi) të lëshuara nga një gjykatë ose autoritet në shtetin kërkues në lidhje me procedimet penale. HMRC nuk është një autoritet qendror për qëllimin e dhënies së dokumenteve.

Autoriteti qendror do t'i japë dokumentet me postë, ose personalisht dorazi në rast se kërkohet. Kur kërkohet në mënyrë specifike dhënia dorazi, autoriteti qendror mund të organizojë që dokumenti të jepet nga policia.

Shumica e kërkesave për kryerjen e procesit nëpërmjet një autoriteti qendror do të pranohen në rast se plotësohen kërkesat e përcaktuara më poshtë. Mund të ketë kërkesa të tjera për t'u përmbushur në çështje të caktuara, dhe autoritetet kërkuese për këtë arsye nxiten të japin informacion të detajuar mbi kërkesën për MLA duke përfshirë:

Kërkesat për Kryerjen e Procesit:

- Detajet e çdo ligji/procedure në shtetin kërkues të cilat kërkojnë që procesi të kryhet nëpërmjet një autoriteti qendror/gjyqësor në shtetin ku bëhet kërkesa.
- Instruksionet specifike nëse dokumentet duhet të jepen dorazi. Në rast se nuk jepet një instruksion i tillë dokumentet do të dërgohen me postë.

- Të gjitha datat e seancave dëgjimore ose të afate të tjera duhet të deklarohen qartë brenda kërkesës.
- Dokumentet duhet të merren nga autoriteti qendror të paktën gjashtë javë përpara seancave gjyqësore ose afateve të tjera të përfshira.
- Detajet e çdo diete dhe shpenzimeve të cilat i takojnë një personi të cilit i kërkohet të paraqitet në procedimet jashtë vendit.
- Adresa e gjykatës ku do të zhvillohen procedimet.
- Emri dhe numri i telefonit i një zyrtari të gjykatës jashtë shtetit nga i cili personit që i kërkohet të paraqitet mund të kërkojë informacione të mëtejshme nëse është e nevojshme.

Në **Angli, Uells** dhe **Irlandën e Veriut**, për rastet jo-fiskale, personit të cilit i bëhet një thirrje ose i jepet një gjykim do t'i kërkohet të nënshkruajë një faturë dhe ta kthejë atë tek UKCA për t'u transmetuar tek autoriteti kërkues, por personi nuk e ka detyrim bëjë atë. Gjithashtu, personi të cilit i jepet thirrja ose gjykimi do të këshillohet se procesi nuk ka efekt ligjor në Mbretërinë e Bashkuar, por që ata mund të dëshirojnë të marrin këshillë mbi efektin në vendin që e ka lëshuar.

UKCA do të këshillojë autoritetin kërkues nëse dokumenti është dorëzuar ose nëse nuk ishte e mundur që dokumenti të dorëzohej.

Në **Skoci**, thirrja do t'i dorëzohet personit ose nga një oficer i policisë ose nga një punonjës i policisë. Oficeri ose punonjësi i policisë do ta kryejnë ekzekutimin e dorëzimit i cili do t'i kthehet autoritetit kërkues. Personit do t'i kërkohet të nënshkruajë një mandat, por nuk është i detyruar ta nënshkruajë atë.

Deklaratat dhe Intervistat

Lloji i Ndhmës	Bashkëpunimi për Zbatimin e Ligjit	Bashkëpunim i Gjyqësor
Deklaratat ose Intervistat	✓	✓

Nëse sistemi ligjor i autoritetit kërkues nuk kërkon që dëshmitë të merren nën betim, kërkesa për MLA duhet të kërkojë që dëshmitë të merren nga një dëshmitar, i dyshuar apo viktimë si një deklaratë ose përmes një interviste. Kjo do të kërkojë **pëlqimin** e individit.

Kërkesat për deklarata, ose intervistat me dëshmitarët, të dyshuarit apo viktimat mund të bëhen mbi bazën e zbatimit të ligjit, në rast se sistemi ligjor i vendit kërkues e lejon këtë.

Policia ose oficerët e tjerë të zbatimit të ligjit nuk janë të autorizuar të administrojnë betimet në Mbretërinë e Bashkuar. Në mbretërinë e Bashkuar dëshmia mund të bëhet subjekt i një betimi vetëm përpara një gjykate (shih më poshtë). Përveç kur një kërkesë e kërkon në mënyrë specifike që dëshmia të jepet nën betim, dëshmia do të merret pa u administruar betimi. Kjo është në mënyrë të konsiderueshme më e shpejtë dhe më pak intensive në burime.

Në rastet kur një individ refuzon të bashkëpunojë për një deklaratë ose intervistë, mund të jetë e mundur që individ të detyrohet të paraqitet në gjykatë.

Megjithatë, dëshmitari mund të ushtrojë **të drejtën kundër vetë-inkriminimit dhe të refuzojë t'i përgjigjet** të gjitha pyetjeve në gjykatë. Prandaj, në rast se një dëshmitar ka qenë jo bashkëpunues duke refuzuar të japë një deklaratë apo pëlqimin për një intervistë, thirrja e atij individ në gjykatë mund të mos jetë e dobishme pasi ai mund të refuzojë t'i përgjigjet pyetjeve që i bëhen (shih 'Dëshmia nën Betim/në Gjykatë, më poshtë).

Udhëzime për kërkesat për Deklarata ose Intervista që duhet të merren nga Policia ose agjencitë e Tjera të Zbatimit të Ligjit:

- Shpjegoni qartë nëse individ që do të intervistohet është dëshmitar, i dyshuar apo viktimë.
- Jepni adresën e individit ose adresën e fundit të njohur.
- Duhet të jepet një listë e pyetjeve që duhen bërë.
- Gjuha që personi kupton duhet të jepet nëse është e mundur.
- Detajet e çdo procedure që duhet të ndiqet gjatë marrjes së dëshmisë, duke përfshirë çdo rregull mbi privilegjet për të cilat mund të ketë të drejtë të kërkojë një dëshmitar apo i dyshuar. Kjo do të zbatohet për aq sa është e mundur sipas ligjit të Mbretërisë së Bashkuar.
- Çdo paralajmërim për të qenë i kujdesshëm ose njoftim zyrtar për të drejtat që duhet t'i jepen dëshmitarit ose të dyshuarit sipas ligjit të shtetit kërkuar. Kjo do të zbatohet për aq sa është e mundur sipas ligjit të Mbretërisë së Bashkuar.

Kontaktimi i personave në Mbretërinë e Bashkuar

Dëshmitarët, viktimat, të dyshuarit dhe të pandehurit, **nuk** duhet të kontaktohen drejtpërdrejt përveç kur agjencitë e zbatimit të ligjit në Mbretërinë e Bashkuar janë informuar më parë, përveç kur ai kontakt është kryerja e drejtpërdrejtë e procesit. Pasi agjencia e zbatimit të ligjit në Mbretërinë e Bashkuar të jetë njoftuar dhe të ketë dhënë pëlqimin, dëshmitari mund të kontaktohet drejtpërdrejt.

Dëshmia nën Betim/në Gjykatë

Lloji i Ndhmës	Bashkëpunimi për Zbatimin e Ligjit	Bashkëpunimi Gjyqësor
Dëshmia nën Betim	X	✓

Kërkesat për dëshmi mund të jenë "të betuara" ose të merren nën betim nga një gjykatë. Gjithashtu është e mundur të merren dëshmi në gjykatë pa qenë nën betim ([lista 1](#), paragrafi 3 i CICA parashikon se "*gjykata mund të marrë dëshmi nën betim*") nëse kjo lejohet sipas ligjit të shtetit kërkues.

Edhe pse një gjykatë e emëruar në bazë të [seksionit 15](#) të CICA ka kompetencë të thërrasë një individ për t'u paraqitur në gjykatë, duhet theksuar se paragrafi 5 i [listës 1](#) të CICA e bën të qartë se një person nuk mund të detyrohet të japë ndonjë dëshmi përpara një gjykate të emëruar, të cilën nuk mund të detyrohen ta japin në procedimet penale në Mbretërinë e Bashkuar ose në shtetin kërkues. Me rëndësi në këtë kontekst janë:

- privilegji kundër vetë-inkriminimit; dhe
- dispozitat e Ligjit të brendshëm të Mbretërisë së Bashkuar që një person *i akuzuar* për një vepër penale nuk mund të detyrohet të japë dëshmi në gjyqin e tij.

Autoriteteve kërkuese u kërkohet të bëjnë një vlerësim shumë të kujdesshme nëse duhet të bëhet një kërkesë që një individ të detyrohet të paraqitet në gjykatë ndërkohë që tashmë ata kanë qenë jo bashkëpunues me hetimin/procedimet (për shembull nëse ata tashmë kanë refuzuar të japin një deklaratë në polici).

Një individ mund të detyrohet të paraqitet në gjykatë, por nëse është e zbatueshme **mund të ushtrojë të drejtën kundër vetë-inkriminimit dhe të heshtë** - pra, në disa rrethana, detyrimi i një dëshmitari të paraqitet në gjykatë nuk ka gjasa të rrisë shanset që të merret ndonjë dëshmi.

Në fund të fundit është që autoriteti qendror që vendos nëse do të emërojë një gjykatë dhe autoriteti qendror do të marrë parasysh të gjitha rrethanat kur e merr atë vendim duke përfshirë detajet e çdo kërkesë ligjore apo procedurale sipas ligjit të brendshëm dhe efektin mbi hetimin apo në ndjekjen penale nëse një person nuk detyrohet të paraqitet në gjykatë.

Në **Skoci** një Prokurori Fiskal (Prokurori Skocez) i kërkohet të kërkojë një urdhër nga një Sherif (gjyqtar i ulët) për të thirrur dëshmitarin/të dyshuarin në Gjykatën Përkatese të Sherifit. Sherifi është i pavarur nga shërbimi i prokurorisë dhe mund të refuzojë të nxjerrë urdhrin nëse nuk ka kriminalitet të dyfishtë, në letrën e kërkesës ka fakte të pamjaftueshme ose për ndonjë arsye tjetër që ai mund ta shohë të përshtatshme.

Udhëzim mbi kërkesat për Provat (Dëshmitë) që duhet të Merren Përpara një Gjykate:

- Shprehimisht deklaroni nëse dëshmia duhet të merret para një gjykate, dhe nëse ajo duhet të jetë nën betim.
- Shpjegoni se përse është e nevojshme që dëshmia të merret në gjykatë, dhe jo nga policia ose një oficer tjetër i zbatimit të ligjit në intervistë.
- Jepni një listë të pyetjeve që duhen bërë.
- Jepni detajet e procedurës së autoritetit kërkues që duhet të ndiqen në marrjen e dëshmisë, duke përfshirë çdo rregull mbi privilegjin që një dëshmitar ose i dyshuar mund të ketë të drejtë të kërkojë. Kjo do të zbatohet për aq sa është e mundur sipas ligjit të Mbretërisë së Bashkuar.
- Çdo paralajmërim për të qenë i kujdesshëm ose njoftim zyrtar për të drejtat që duhet t'i jepen dëshmitarit ose të dyshuarit sipas ligjit të shtetit kërkues. Autoritetet qendrore do të synojnë t'i respektojnë këto procedura dhe kërkesa për aq sa është e mundur sipas ligjit të Mbretërisë së Bashkuar.

Privilegji

Nëse një individ kërkon privilegjin sipas ligjit të shtetit kërkues, dhe nëse autoriteti kërkues e pranon kërkesën, dëshmia nuk do të merret. Kur kërkesa nuk pranohet, dëshmia mund të merret, por nuk do t'i dërgohet autoritetit kërkues derisa një gjykatë në shtetin kërkues të vendosë për këtë çështje.

Seancat dëgjimore përmes Konferencës me Video apo me Telefon

Lloji i Ndihmës	Bashkëpunimi për Zbatimin e Ligjit	Bashkëpunimi Gjyqësor
Seanca Dëgjimore me Video Konferencë	X	✓
Seanca Dëgjimore me Konferencë me Telefon	X	✓

Video Konferencë (Lidhje Televizive)

Baza për të dëgjuar dëshmitarë në Mbretërinë e Bashkuar përmes video konferencave është [seksioni 30](#) i CICA. Në bazë të seksionit 30, në rastin që Mbretëria e Bashkuar merr një kërkesë për MLA, lidhja me video duhet të bëhet nga mjediset e gjykatës së Mbretërisë së Bashkuar në prani të një gjykatësi të Mbretërisë së Bashkuar (shih [Lista 2 e CICA](#) mbi kompetencat e gjykatës së emëruar dhe mbrojtjet për dëshmitarin).

Ju lutemi vini re se Mbretëria e Bashkuar ka një rezervë për Protokollin e Dytë Shtesë të Konventës Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale 1959, me efektin që nuk do të lejojë përdorimin e lidhjeve me video kur dëshmitari në fjalë është i pandehuri ose i dyshuari dhe seanca dëgjimore është, ose përbën pjesë të gjyimit të atij personi.

Nëse autoriteti kërkues nuk mund t'i bjerë numrit të Mbretërisë së Bashkuar, atij do t'i ngarkohen shpenzimet për konferencën me video (Skocia nuk ua ngarkon shpenzimet autoriteteve kërkuese për kostot e lidhjes televizive).

Ju lutemi vini re se HMRC nuk mund të organizojë lidhje me video.

Udhëzim për kërkesat për dhënien e Dëshmisë nëpërmjet Konferencës me Telefon:

- Ju lutemi përpquni të siguroheni të njoftoni të paktën **tetë javë** përpara datës së seancës dëgjimore me video konferencë.
- Një orar i propozuar gjatë ditës kur duhet të dëgjohet lidhja dhe kohëzgjatja për të cilën kërkohet dëshmitari.
- Adresa e emailit e një personi nga autoriteti kërkues, i cili mund të kontaktohet në një kohë të shkurtër i cili do të ofrojë asistencë teknike.
- Informacion i mjaftueshëm që i mundëson autoritetit qendror identifikimin dhe kontaktin e dëshmitarit ose dëshmitarëve.
- Përfshini gjuhën e dëshmitarit, nëse dihet.
- Detajet e kërkesave të procedurës që duhen ndjekur gjatë marrjes së dëshmisë, duke përfshirë çdo rregull mbi privilegjin të cilin mund të ketë të drejtë ta kërkojë dëshmitari.
- Çdo paralajmërim për të qenë i kujdesshëm ose njoftim zyrtar mbi të drejtat që duhet t'i jepet dëshmitarit sipas ligjit të shtetit kërkues.
- Detajet (nëse dihen në atë kohë) të kërkesave teknike për vendosjen e lidhjes për të siguruar përputhshmërinë.

Konferenca me Telefon

Baza për dëgjimin e dëshmitarëve në Mbretërinë e Bashkuar nëpërmjet konferencës me telefon është [seksioni 31](#) dhe [lista 2](#) e CICA. Ky seksion zbatohet vetëm për vendet përkatëse pjesëmarrëse dhe nuk zbatohet për kërkesat që përpunohen nga HMRC.

Udhëzim për kërkesat për Dëshmi Nëpërmjet Konferencës me Telefon:	
✓	Ju lutemi përpikuni të siguroheni të njoftoni të paktën tetë javë përpara datës së lidhjes me telefon për seancën dëgjimore.
✓	Konfirmim se dëshmitari ka rënë dakord shprehimisht të japë dëshmi nëpërmjet lidhjes me telefon.
✓	Emri dhe adresa e dëshmitarit që do të merret në pyetje.
✓	Detajet e kërkesave të procedurës që duhen ndjekur gjatë marrjes së dëshmisë, duke përfshirë çdo rregull mbi privilegjin të cilin dëshmitari mund të ketë të drejtë ta kërkojë.
✓	Çdo paralajmërim për të qenë i kujdesshëm ose njoftim zyrtar për të drejtat që duhet t'i jepen dëshmitarit ose të dyshuarit sipas ligjit të shtetit kërkuar.

Kontrolli dhe Sekuestrimi

Lloji i Ndhmës	Bashkëpunimi për Zbatimin e Ligjit	Bashkëpunimi Gjyqësor
Kontrolli & Sekuestrimi	X	✓

Nuk është e mjaftueshme që një kërkesë për MLA të shoqërohet me një urdhër kontrolli të lëshuar nga një autoritet në shtetin kërkuar. Kërkohet një urdhër kontrolli i lëshuar nga një gjykatë në Mbretërinë e Bashkuar.

Autoritetet qendrore dhe ekzekutuese në Mbretërinë e Bashkuar nuk kanë autoritetin për të lëshuar vetë një urdhër kontrolli; autoriteti zbatues duhet të bëjë një kërkesë në gjykatë në Mbretërinë e Bashkuar për lëshimin e urdhrit të kontrollit.

Për më tepër, kërkesat për kontroll dhe sekuestrim kërkojnë **kriminalitet të dyfishtë**. Nëse provat e kërkuara mund të merren me metoda më pak ndërhyrëse (pa marrë dhe ekzekutuar një urdhër kontrolli), atëherë duhet të bëhen përpjekje të përdoren ato dhe do të kontaktohet shteti kërkuar për të diskutuar mundësitë.

Llojet e mëposhtme të materialit nuk mund të jenë objekt i një urdhër kontrolli:

- **“materiali i përjashtuar”** i cili përfshin të dhëna gazetareske konfidenciale, të dhëna mjekësore dhe mostra, të dhënat nga konsultimet.

- **"materiale që janë ligjërisht të privileguara"** të cilët përfshijnë materiale në lidhje me këshillat e dhëna nga një avokat për klientin e tij, përveç rastit kur një material i tillë mbahet me qëllimin e arritjes së një qëllimi kriminal.

Konsiderata të veçanta zbatohen ndaj **"materialit të procedurës së posaçme"**, i cili përfshin dokumente të tjera konfidenciale tregtare dhe materiale gazetareske jo-konfidenciale. Në shumicën e rasteve ato do të merren nëpërmjet urdhrit për dorëzimin e provave dhe jo me një urdhër kontrolli (shih urdhrat për dorëzimin e provave më poshtë). Megjithatë, ekzistojnë rrethana kur mund të lëshohet një urdhër kontrolli në lidhje me materialin e procedurës së posaçme. Për shembull, kur dhënia e një njoftimi mbi një kërkesë për një urdhër të dorëzimit të provave mund të pengojë seriozisht hetimin ose kur një urdhër për dorëzimin e provave në lidhje me materialet e procedurës së posaçme nuk është zbatuar. Në këtë rast, në rast se plotësohen kushte të tjera, mund të lëshohet një urdhër për kontrollin dhe sekuestrimin e materialit të procedurës së posaçme.

Udhëzim për kërkesat për Kontrollin dhe Sekuestrimin e Provave

- ✓ Kushtet e përcaktuara në [seksionin 8](#) të Ligjit për Policinë dhe Provat Penale 1984 ("PACE") duhet të zbatohen (ose Lista 1 e PACE në rastin e një urdhër kontrolli për materialet e procedurës së posaçme).
- ✓ Duhet të ekzistojë kriminaliteti i dyfishtë.
- ✓ Kërkohet një përshkrim i plotë i veprimtarisë kriminale në fjalë.
- ✓ Adresa/adresat e plota, ose një përshkrim i saktë i vendeve ku do të kontrollohet.
- ✓ Një shpjegim i plotë se ku pritët të gjendet një material i caktuar ose lloji i materialit, në rastet kur dihet, p.sh. brenda shtëpisë, në mjediset e garazhit, në mjediset e kopshtit.
- ✓ Detaje se si lidhet vendi që do të kryhet kontrolli me çështjen/personin e dyshuar.
- ✓ Detajet e plota të materialit specifik ose të llojit të materialit që do të sekuestrohet (zakonisht nuk mjafton të deklarohet thjesht "provat relevante për hetimin"), dhe çdo informacion në dispozicion i cili tregon se materiali i kërkuar mund të ruhet në një kompjuter.
- ✓ Pse materiali i kërkuar konsiderohet si provë relevante dhe e rëndësishme për hetimin ose procedimet.
- ✓ Pse mendohet se provat janë në ato mjedise të caktuara ose në zotërim të personit të caktuar në fjalë.

- ✓ Përse materiali nuk do të paraqitet në një gjykatë të Mbretërisë së Bashkuar në rast se personi fizik ose juridik që e mban materialin është urdhëruar ta bëjë këtë me anë të një letër-thirrje për dëshmitar (kjo bëhet për t'u siguruar që aplikimet në gjykatat e Mbretërisë së Bashkuar për urdhrat e kontrollit të jenë të suksesshme dhe të ketë më pak gjasa të dështojnë ose t'i nënshtrohet kundërshtimit ligjor të mëvonshëm).
- ✓ Veprimet e duhura për ruajtjen e sigurt dhe kthimin e çdo prove të sekuestruar.
- ✓ Në rast se pritet që oficerët e zbatimit të ligjit mund të hasin në "materiale të procedurës së posaçme" gjatë ushtrimit të kontrollit.
- ✓ Të dhënat e çdo zyrtari nga shteti kërkues që dëshiron të marrë pjesë gjatë kontrollit dhe përse prania e tyre është e nevojshme (ju lutemi vini re – ne preferojmë që oficerët nga shteti kërkues të përfshihen gjatë kontrollit kur është e mundur).
- ✓ Çdo informacion tjetër që do të ishte i dobishëm nga ana operacionale për autoritetin zbatues në lidhje me ekzekutimin e kërkesës.

Gjithashtu rekomandohet që vlerësimi i urdhrat të kontrollit të diskutohet mbi bazën e zbatimit të ligjit përpara se të bëhet kërkesa për MLA.

Sekuestrimi i Kompjuterëve dhe Vend-ruajtjeve të tjera të Medias

Vetëm në rrethana të jashtëzakonshme kompjuterët, telefonat inteligjentë ose vend-ruajtjet e tjera të medias (ose imazhet e tyre) do t'i jepen drejtpërdrejt autoritetit kërkues. Zakonisht, këto pajisje nuk do t'i jepeshin një autoriteti kërkues, pasi ato pajisje pothuajse gjithmonë do të përmbajnë materiale që nuk janë mbuluar nga urdhri origjinal i kontrollit në bazë të të cilit do të ishte bërë sekuestrimi.

Pas sekuestrimin, këto pajisje ekzaminohen ose shkarkohen nga oficerët e policisë së Mbretërisë së Bashkuar, të cilët do të sigurohen që materiali ka qenë i përfshirë në urdhrin origjinal të kontrollit dhe që të mos përmbajë materiale të cilët janë ligjërisht të privileguara. Pas një kontrolli për materialin nga policia e Mbretërisë së Bashkuar, mund të jetë e nevojshme që oficerët nga shteti kërkues të vizitojnë Mbretërinë e Bashkuar që të përfshihen gjatë ekzaminimit.

Kur kërkohet informacion i mëtejshëm në lidhje me veprën penale ose me materialin që do të sekuestrohet, në varësi të rrethanave të veçanta, UKCA do të informojë pa vonesë autoritetet kërkuese. Njoftimi i palëve të interesuara nuk kërkohet kur bëhet një kërkesë për një urdhër kontrolli.

Kërkesat për Kontroll dhe Konfiskim në Skoci

Zyra e Kurorës në Skoci mund të udhëzojë një Prokuror Fiskal (prokurorin) që të kërkojë nxjerrjen e një urdhër kontrolli nga një Sherif përpara Gjykatës përkatëse të Sherifit. Në lidhje me testin për kriminalitetin e dyfishtë, krimi ekuivalent në Skoci duhet të jetë një vepër penale e dënueshme me burgim ([seksioni 18\(1\) \(b\)](#) i CICA). As policia dhe as HMRC nuk mund të aplikojnë për një urdhër kontrolli në Skoci. Palët e interesuara nuk njoftohen për kërkesën për nxjerrjen e urdhrit të kontrollit.

Koncepti i privilegjit ligjor zbatohet në mënyrë të njëjtë në **Skoci**.

Urdhrat për Dorëzimin e Provave

Lloji i Ndihmës	Bashkëpunimi për Zbatimin e Ligjit	Bashkëpunimi Gjyqësor
Urdhër për Dorëzimin e Provave	X	✓

Urdhrat për Dorëzimin e Provave zakonisht përdoren për të marrë një material specifik që shpesh quhet "Material i Procedurës së Posaçme", zakonisht nga institucionet financiare apo kontabilistët. Ata kërkohen sepse oficerët e zbatimit të ligjit zakonisht nuk janë në gjendje t'i marrin provat vullnetarisht nga bankat dhe organizatat e tjera që janë nën detyrimin profesional që të mos zbulojnë asnjë material të klientit pa një urdhër gjykate.

Do të ketë gjithashtu organizata të mëdha korporative të cilat, megjithëse mund të mos jenë nën detyrimin profesional për ta ruajtur materialin, do të preferonin një urdhër gjykate përpara se t'u dorëzojnë informacionin oficerëve të zbatimit të ligjit.

Shembuj të Materialit të Procedurës së Posaçme (jo shterues)
✓ Përmbajtja e komunikimeve (shih më poshtë për më shumë detaje). ✓ Prova bankare. ✓ Të dhënat që ruhen nga kontabilistët etj. ✓ Të dhënat e korporatave që ruhen në besim.

Urdhrat për Dorëzimin e Provave: Procesi në Angli & Uells dhe Irlandën e Veriut

Pasi një kërkesë për material të procedurës së posaçme pranohet nga autoriteti qendror, aty ku nuk kërkohet një urdhër kontrolli (shih "Kontrolli dhe Konfiskimi" më sipër), autoriteti qendror do të lëshojë një udhëzim në bazë të [seksionit 13](#) të CICA që policia t'i bëjë kërkesë gjykatës për një urdhër për dorëzimin e provave në bazë të [seksionit 16](#) të CICA (urdhrat për dorëzimin e provave mund të merren edhe në bazë të Nenit 6 të [Ligjit për](#)

Produktet e Krimit 2002 (Hetimet e Huaja) Urdhri 2014 për qëllimin e hetimeve për kufizimet dhe të konfiskimit).

Kërkesa për nxjerrjen e urdhrit për dorëzimin e provave do të bëhet në Gjykatën e Kurorës përpara një gjyqtari të qarkut dhe normalisht do të aplikohet me anën e njoftimit (*inter partes* për organizatën që e mban informacionin) për t'u siguruar që i padituri (për shembull një bankë) të ketë mundësinë të përfaqësohet në gjykatën që shqyrton kërkesën në seancën dëgjimore. Kur organizata paraqitet, autoriteti qendror do të konsultohet me autoritetin kërkues për të siguruar që ekzekutimi i kërkesës nuk do të shkelë asnjë kërkesë të konfidencialitetit.

Urdhri për Dorëzimin e Provave në bazë të Ligjit për Produktet e Krimit 2002 Urdhri 2014 (Hetimet e Huaja) mund të nxirret *ex parte*. Për t'u theksuar, në rast se një seancë e tillë mund të paragjykojë ndonjë kërkesë për konfidencialitetin në shtetin kërkues, kjo duhet të përmendet në mënyrë eksplicite në kërkesë në mënyrë që një aplikim *ex parte* të merret në konsideratë. Autoriteti qendror do të japë informojë për çdo informacion të mëtejshëm që kërkohet për të aplikuar për një seancë dëgjimore *ex parte*.

Urdhrat për Dorëzimin e Provave: Procesi Në Skoci

Kërkohet një udhëzim nga Lordi Avokat [Këshilltari Juridik] në bazë të seksionit 13 të CICA për të kërkuar një urdhër kontrolli në bazë të seksionit 18 të CICA. Më pas i padituri do të paraqesë dokumentacionin përkatës dhe deklaratat e dëshmitarëve në polici në përgjigje të urdhrit të dorëzimit të provave i cili nga ana e tij do t'i përcillet autoritetit kërkues.

Provat Bankare

Gjurmimi i aseteve duhet të përfundojë përpara se të bëni një kërkesë për provat bankare (shih **Pjesën 4** në lidhje me gjurmimin e aseteve).

Informacioni që do të Merret <i>Para</i> se të Bëhet një Kërkesë për Provat Bankare
✓ Emri i institucionit financiar.
✓ Emri i mbajtësit të llogarisë.
✓ Numri i llogarisë.
✓ Adresa dhe / ose numri ("sort code") i degës së bankës ku mbahet llogaria.

Pasi të jetë marrë ky informacion, kërkesa duhet të përmbajë të gjitha sa më poshtë:

Udhëzime për kërkesat për Provat Bankare

✓	Detajet e llogarisë (ve) (si më sipër).
✓	Bazat mbi të cilat besohet se bankat në Mbretërinë e Bashkuar mbajnë llogari dhe në masën e disponueshme, cilat banka mund të jenë të përfshira.
✓	Periudha kohore për të cilën kërkohet informacioni (duhet të jepet një shpjegim për çdo periudhë që është jashtë kornizës kohore të hetimit).
✓	Dokumentet specifike të kërkuara (p.sh. informacioni për hapjen e llogarisë, deklaratat bankare, etj) dhe rëndësia e tyre për hetimin.
✓	Konfirmim se ekziston kriminaliteti i dyfishtë.

Ju lutemi të jeni të vetëdijshëm se politikat bankave për mbajtjen e informacionit variojnë në rreth **5 vjet**.

Ju lutemi vini re se Autoriteti Qendror i Mbretërisë së Bashkuar merr një sasi të madhe të kërkesave për marrjen e provave bankare në Angli dhe Uells dhe kjo mund të ulë shpejtësinë me të cilën ekzekutohet një kërkesë.

Kriptomonedha

Për sa i përket kërkesave për prova si rezultat i shkëmbimeve të kriptomonedhave me bazë në Mbretërinë e Bashkuar, duhet të ofrohet informacion ekuivalent me atë që kërkohet për provat bankare. Prandaj, kërkesat duhet të përfshijnë informacione të tilla si:

- Identifikimi i përdoruesit që është subjekt.
- Adresat e portofolit ose Identifikimi/Identifikimet.

Gjithashtu, shkëmbimet e kriptomonedhave mund të kërkojnë disa nga identifikuesit e mëposhtëm:

- Përshkrimet e pagesave dhe / ose referencat e transaksionit.
- Nëse përdorni shkëmbimin për të blerë kriptomonedhë ose për të kthyer kriptomonedhën në monedhën fiat, dërguesi/marrësi IBAN (Numri i Llogarisë Ndërkombëtare të Bankës), duke përfshirë kodin e bankës dhe numrin e llogarisë, dhe shumën e dërguar/marrë në monedhën kombëtare (fiat).
- Data dhe ora në të cilën është kryer transaksioni(et).
- Identifikues të tjerë (mund të përfshijnë emrin e mbajtësit të llogarisë, datën e lindjes, adresën e postës elektronike dhe numrin e telefonit).

Urdhra për Monitorimin e Llogarisë

Lloji i Ndhmës	Bashkëpunimi për Zbatimin e Ligjit	Bashkëpunimi Gjyqësor
Urdhri për Monitorimin e Llogarisë	X	✓

Urdhri për Monitorimin e Llogarisë mundëson monitorimin e transaksioneve në një llogari të caktuar për një periudhë të caktuar kohore. Urdhrat për Monitorimin e Llogarisë në bazë të [seksionit 35](#) të CICA zbatohen **vetëm** kur hetohen sjellje të rënda kriminale nga një "shtet pjesëmarrës".

Udhëzues për kërkesat për Urdhrin e Monitorimit të Llogarisë në bazë të CICA:
✓ Kërkesa duhet të bëhet nga një "shtet pjesëmarrës" siç përcaktohet me urdhër të Sekretarit të Shtetit ose, në rastin e Skocisë, të Ministrave Skocezë.
✓ Specifikoni "institucionin financiar" dhe llogaritë e mbajtura atje nga një person i caktuar.
✓ Në shtetin kërkues është duke u zhvilluar një hetim për sjellje kriminale.
✓ Urdhri kërkohet për qëllimet e hetimit.

Urdhrat për Monitorimin e Llogarisë mund të kërkohen gjithashtu në bazë të [Pjesës 5](#) të Urdhrit për [Produktet e Krimit 2014 \(Hetimet e Huaja\) \(Urdhri POCA\)](#).

Udhëzues për kërkesat për nxjerrjen e një Urdhri për Monitorimin e Llogarisë në bazë të Pjesës 5 të Urdhrit POCA:
✓ Urdhrat për Monitorimin e Llogarisë mund të merren për qëllimin e një hetimi të jashtëm në lidhje me një hetim penal ose procedim penal në shtetin kërkues, me kusht që hetimi t'i përgjigjet përkufizimit të përcaktuar në Pjesën 8 të POCA 2002:
✓ Pjesa 8 e POCA trajton dy lloje hetimi. ✓ Një hetim konfiskimi, i cili është një hetim për: a) nëse një person ka përfituar nga veprimtaria e tij kriminale, ose; b) shumën ose vendndodhjen e përfitimit të tij nga veprimtaria e tij kriminale. ✓ Një hetim për rikuperimin civil, i cili është një hetim për: a) nëse prona është pronë e rikuperueshme ose pronë e lidhur me të, b) kush e mban pronën, ose; c) shtrirja ose vendndodhja e saj.

- ✓ Kërkesa duhet të tregojë se ekzistojnë baza të arsyeshme për të besuar se informacioni mbi llogarinë i cili kërkohet është me vlerë të konsiderueshme për hetimin e jashtëm dhe se publikimi i informacionit të llogarisë është në interesin publik.

Komunikimet dhe të Dhënat e Përmbajtjes

Ekziston një ndryshim ndërmjet të **Dhënave** të Komunikimit dhe **Përmbajtjes** së Komunikimit.

- ✓ **Të dhënat** mund të merren me kërkesë të ofruesit të rrjetit dhe përfshijnë detaje për kohën e thirrjeve (që janë bërë dhe marrë), numrat e telefonit, listat e telefonatave, vendndodhjen e thirrjeve, kohën e mesazheve (që janë dërguar dhe marrë), detaje se kush është i regjistruar me numrin e telefonit.
- ✓ **Përmbajtja** përbëhet nga tërësia e informacionit të mësipërm, për shembull, përmbajtja reale e mesazheve të dërguara, historia e regjistrimeve të adresave IP për çdo telefonatë të bërë, përmbajtja e rrjeteve sociale, mesazhet dhe historiku i kërimit.

Përmbajtja e Komunikimit

Përmbajtja e komunikimit mund të merret gjithashtu nëpërmjet një urdhri për dorëzimin e të dhënave. Ju lutemi vini re se është e mundur të kërkohet ruajtja e të dhënave të përmbajtjes nëpërmjet kanaleve të zbatimit të ligjit në pritje të ekzekutimit të kërkesës për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike (MLA) (shihni "Kërkesat për ruajtjen e të Dhënave të Komunikimit" më poshtë).

Të dhënat e Komunikimit

Lloji i Ndihmës	Bashkëpunimi për Zbatimin e Ligjit	Bashkëpunimi Gjyqësor
Të dhënat e Komunikimit	✓	✓

Të dhënat e komunikimit i referohen "**kush**", "**kur**", "**ku**" dhe "**si**" të komunikimit, por **jo përmbajtjes** së komunikimit. Këtu përfshihen mesazhe me tekst dhe emailt (duke përjashtuar përmbajtjen) si dhe telefonatat. Të dhënat e komunikimit mund të kërkohen në bazë të bashkëpunimit për zbatimin e ligjit.

Nëse kërkesa pranohet, ajo do t'i përcillet agjencisë përkatëse për zbatimin e ligjit, e cila do të marrë provat në bazë të **Ligjit mbi Kompetencat për Kryerjen e Hetimeve 2016**.

Nëse autoriteti kërkues kërkon që dëshmia të jepet nën betim në gjykatë nga një punonjës i ofruesit të shërbimit të komunikimit, nga i cili kërkohen të dhënat e komunikimit, atëherë autoriteti qendror cakton një gjykatë për të marrë provat në bazë të [seksionit 15](#) të CICA (shihni më sipër për dëshmitë nën betim).

Në Mbretërinë e Bashkuar, ofruesve të shërbimeve u kërkohet me ligj që t'i ruajnë të dhënat vetëm për 12 muaj. Megjithatë disa nga ofruesit e shërbimeve, të tillë si ofruesit e shërbimeve telefonike me kontratë, mund t'i ruajnë të dhënat e faturimit deri në 6 vjet. Është e mundur të kërkohet ruajtja e të dhënave të komunikimit nëpërmjet kanaleve të zbatimit të ligjit (shikoni më poshtë).

Udhëzuesi për Kërkesat në lidhje me të Dhënat e Komunikimit:	
✓	Specifikoni llojin e të dhënave të kërkuara p.sh. të dhëna për abonimin, thirrjet hyrëse, thirrjet dalëse.
✓	Shpjegoni pse janë të nevojshme periudhat kohore të të dhënave të kërkuara.
✓	Shpjegoni pse informacioni është i nevojshëm për hetimin. Ai duhet të përfshijë veprën penale që po hetohet, mënyrën se si personi specifik është i lidhur me hetimin dhe si lidhen të dhënat e kërkuara me veprën penale dhe personin e specifikuar.
✓	Arsyetoni pse të dhënat janë proporcionale me hetimin, p.sh. çfarë pritet të tregojnë dhe si do të përdoren të dhënat.
✓	Jepni informacion në lidhje me burimin e numrave të telefonit ose adresave IP.
✓	Për aq sa është e mundur, jepni datën, kohën dhe vendin e saktë të incidentit nën hetim.
✓	Për aq sa është e mundur, jepni informacion të plotë për individët e përfshirë në incident dhe rolet që kanë luajtur.
✓	Shpjegoni pse objektivat e hetimit nuk mund të arrihen me mjete të tjera.
✓	Shpjegoni nëse privatësia e personave që nuk janë nën hetim do të cenohet dhe nëse po, pse rrethanat e çështjes justifikojnë një ndërhyrje të tillë.

Kërkesat për Ruajtjen e të Dhënave të Komunikimit

Për të parandaluar fshirjen e të dhënave të komunikimit ose ndryshimin e formatit ose gjendjes së tyre, është e mundur të kërkohet ruajtja e menjëhershme e tyre në pritje të lëshimit dhe ekzekutimit të një kërkesë për MLA. Kërkesa për ruajtje i referohet vetëm ngrirjes së të dhënave të kërkuara në formën e tyre aktuale dhe nuk lejon zbulimin e menjëhershëm të informacionit nga ofruesi i shërbimit pa kërkuar informacionin përkatës nëpërmjet kanaleve zyrtare të MLA. Për shkak të kohës që shpesh nevojitet për përgatitjen dhe përpunimin e kërkesave të MLA-së, pa një urdhër ruajtjeje deri në kohën kur autoriteti

qendror merr një kërkesë për MLA për të dhënat e komunikimit, të dhënat mund të jenë fshirë ose të kenë humbur.

Prandaj, rekomandohet që autoritetet kërkuese të kërkojnë ruajtjen e të dhënave drejtpërdrejt nga ofruesi i shërbimit ose nëpërmjet kanaleve të bashkëpunimit për zbatimin e ligjit përpara se të bëjnë një kërkesë zyrtare për MLA. Protokoli G7 dhe Konventa Evropiane për Krimin Kibernetik, e njohur si [Konventa e Budapestit](#), e bëjnë më të lehtë sigurimin dhe ruajtjen e të dhënave të paqëndrueshme për shtetet anëtare ndërkohë që përpunohen kërkesat juridike të cilat kërkojnë më shumë kohë.

Ruajtja dhe mbrojtja e të dhënave të paqëndrueshme ndërkohë që përgatitet procesi ligjor

Një shqetësim i veçantë, kur kërkesa për MLA kërkon që të sigurohen prova elektronike, është se shpesh mund të duhen shumë javë që kërkesa për MLA të plotësohet. Ekziston një proces për ta bërë më të lehtë mbrojtjen e të dhënave kompjuterike të cilat mund të ndryshohen ose shkatërrohen shpejt, veçanërisht duke pasur parasysh se vende të ndryshme kanë rregulla të ndryshme për kohën që ruhen të dhënat tilla përpara se të fshihen (në MB zakonisht kjo periudhë është 12 muaj, por shihni "Si të bëni një kërkesë për ruajtjen e të dhënave" më poshtë).

Ekipi i Hetimeve të Infrastrukturës së NCA (pjesë e Njësisë Kombëtare të Krimeve Kibernetike të NCA) shërben si pikë kontakti e rrjetit të MB gjatë 24/7, si për [Konventën e Budapestit](#) ashtu edhe për Marrëveshjen e Romës dhe Lionit të G7 (shikoni të dhënat e kontaktit më poshtë). Këto Rrjete që funksionojnë 24 orë dhe 7 ditë në javë, përqendrohen në bashkëpunimin e ndërsjellë trans-kombëtar me pika të tjera relevante ndërkombëtare të kontaktit të vetëm. Nëpërmjet këtyre rrjeteve, homologët nga agjencitë anëtare mund të kërkojnë sigurimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave dhe llogarive nga ofruesi përkatës i shërbimit në Mbretërinë e Bashkuar brenda një periudhe të shkurtër kohore. Ekipi i MB është përgjegjës për të gjitha kërkesat për ruajtjen e të dhënave kompjuterike në MB dhe për të gjitha kërkesat e bëra në adresë të MB.

Përdorimi i ekipit të NCA G7 (përfshirë Konventën e Budapestit) dhe ekipet e tyre ndërkombëtare ekuivalente mundëson këshillim dhe përpunim të shpejtë dhe të kualifikuar për t'u siguruar që të dhënat elektronike të paqëndrueshme të mos humbasin ose ndryshohen përpara se të mund të përdoren në procedimet juridike. Llojet e të dhënave që ruhen sipas të dyja marrëveshjeve përfshijnë adresat IP, adresat e emailit, emrat e domenit, llogaritë e mediave sociale dhe identifikuesit e kriptomonedhave, por mund të mbulojnë fusha të tjera.

Si të bëni një kërkesë për ruajtjen e të dhënave

Për të bërë një kërkesë për ruajtjen e të dhënave, si minimum, kërkohet informacioni i mëposhtëm dhe kërkesat do të vlerësohen rast pas rasti:

- Një përmbledhje e shkurtër e hetimit duke përfshirë se cilat ligje janë shkelur (krimi dhe legjislacioni që është shkelur).
- Identifikuesit me orën/datën dhe zonën kohore përkatëse (p.sh. IP, domeni, emaili, emri i llogarisë dhe data/ora me sekonda në formatin UTC kur është e aplikueshme).
- Çfarë duhet të ruhet dhe si lidhen identifikuesit me krimin.

Kërkesat drejtuar ekipit G7 të NCA duhet të koordinohen nga një ekip kontakti ekuivalent në vendin kërkues që punon 24/7 i cili është nënshkruar i njëjës ose i të dyjave - [Konventës së Budapestit për Krimin Kibernetik](#) ose Marrëveshjes së G7 ndërmjet Romës dhe Lionit (së bashku ato mbulojnë mbi 100 shtete).

Ju lutemi vini re se nëse kompania që mban të dhënat është një Operator Telekomunikacioni (TO) ata do t'i ruajnë të dhënat për 12 muaj, por kompanitë që nuk janë Operator Telekomunikacioni, normalisht do t'i ruajnë të dhënat për një kohë të caktuar - shpesh kjo kohë është 90 ditë, por kjo ndryshon nga kompania në kompani. Kjo do të thotë se autoriteti kërkues mund të kërkojë zgjatjen e kohës së ruajtjes deri sa të plotësohet kërkesa për MLA, por ekipi i G7 i NCA (duke përfshirë Konventën e Budapestit) do t'ju njoftojë për këtë në varësi të situatës specifike.

Të dhënat e kontaktit të G7 NCA – Ekipi i Hetimeve të Infrastrukturës:

- ✓ Email: G7@nca.gov.uk
- ✓ Adresa:
Infrastructure Investigations
National Cyber Crime Unit
Agjencia Kombëtare e Krimit
PO Box 8000, London
SE11 5EN

Përgjimi i Drejtpërdrejtë i Komunikimeve

Lloji i Ndihmës	Bashkëpunimi për Zbatimin e Ligjit	Bashkëpunimi Gjyqësor
Përgjimi i Komunikimeve	X	X

Ju lutemi vini re se Mbretëria e Bashkuar nuk është më palë në marrëveshjet ndërkombëtare që lejojnë në mënyrë specifike përgjimin e komunikimeve sipas MLA. Për këtë arsye, autoritetet qendrore nuk mund të pranojnë kërkesa sipas MLA për përgjimin e komunikimeve nga asnjë vend.

Informacion për pasaportën dhe Statusin e Imigracionit

Lloji i Ndhmës	Bashkëpunimi për Zbatimin e Ligjit	Bashkëpunimi Gjyqësor
Regjistrimet e Pasaportave / Statusi i Imigracionit	✓	✓

Kërkesat për këtë informacion mund të bëhen nëpërmjet bashkëpunimit për zbatimin e ligjit. Të gjitha kërkesat për MLA do t'i referohen Zyrës së Pasaportave të HM, Vizat dhe Imigracioni në Mbretërinë e Bashkuar ose Autoritetit për Zbatimin e Ligjit të Imigracionit, sipas rastit.

Udhëzues për kërkesat për sigurimin e Informacionit për Pasaportë / Statusin e Imigracionit
✓ Të dhënat e personit (emri, data e lindjes dhe vendi i lindjes nëse dihet).
✓ Numri i pasaportës (aktual dhe i mëparshëm).
✓ Tregoni nëse kërkesa ka të bëjë me parandalimin dhe zbulimin e krimit ose kapjen ose ndjekjen penale të shkelësit.
✓ Si lidhen të dhënat që kërkohen me veprën penale që është duke u hetuar.

Të Dhënat e Regjistruara e Kompanisë

Lloji i Ndhmës	Bashkëpunimi për Zbatimin e Ligjit	Bashkëpunimi Gjyqësor
Të Dhënat e Regjistruara e Kompanisë	✓	✓

Rekomandohet që përpara se të kërkohet ndihmë nga autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar, t'i kushtohet vëmendje kryerjes së një kërkimi në internet me burim të hapur për kompanitë, adresat dhe numrat e telefonit të drejtorëve të tyre.

Informacion për një kompani në **Angli, Uells, Irlandën e Veriut** ose **Skoci** mund të gjendet në [faqen e internetit](#) të Companies House.

Kërkimi për **Companies House** [Regjistri i Kompanive] mund të bëhet nga kjo [faqe](#), e cila përmban lidhje me shërbimet e tjera të Companies House për të gjetur informacion rreth kompanive, disa prej të cilave janë pa pagesë.

Gjendja Gjyqësore

Lloji i Ndhmës	Bashkëpunimi për Zbatimin e Ligjit	Bashkëpunimi Gjyqësor
Gjendja Gjyqësore	✓	✓

Megjithëse kërkesat për gjendjen gjyqësore mund të jenë pjesë e një kërkesë më të gjerë formale për MLA, autoritetet kërkuese **zakonisht nuk duhet** të marrin informacion për gjendjen gjyqësore nga UKCA (**Angli, Uells dhe Irlanda e Veriut**) ose Zyra e Kurorës (**Skoci**), por duhet të përdorë bashkëpunimin me autoritetet e zbatimit të ligjit.

Kërkesat nga Shtetet Anëtare të BE-së

Shtetet Anëtare të BE-së duhet të shkëmbejnë informacion për të dhënat kriminale drejtpërdrejt me Mbretërinë e Bashkuar nëpërmjet Sistemit të Informacionit të të Dhënave Kriminale në MB (UK-CRIS).

Pjesa 3, Titulli IX i Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet BE-MB parashikon shkëmbimin e të dhënave penale ndërmjet MB dhe Shteteve Anëtare individuale të BE-së nëpërmjet një infrastrukture të përbashkët që plotëson Nenin 13 dhe 22(2) të Konventës Evropiane për Ndhmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale të vitit 1959 dhe Protokollet e saj Shtesë. Marrëveshjet përfshijnë procedura të thjeshtuara dhe të kufizuara në kohë për ndarjen e informacionit mbi të dhënat penale dhe specifikojnë se informacioni mund të ndahet për qëllimet e parandalimit të krimit dhe për sigurinë.

Mbretëria e Bashkuar ka deklaruar se autoriteti qendror tek i cili duhet të bëhen kërkesat për informacion mbi dënimet është [Zyra e Gjendjes Gjyqësore ACRO](#) (ACRO) - Autoriteti Qendror i Mbretërisë së Bashkuar për Shkëmbimin e Informacionit mbi të Dhënat Penale. Në këtë kuptim, Shtetet Anëtare të BE-së duhet t'i dërgojnë ACRO-së kërkesa për të dhënat mbi gjendjen gjyqësore.

Të dhënat e kontaktit të ACRO

✓ www.acro.police.uk/s/contact-us

Shtetet Anëtare të BE-së duhet të bëjnë kërkesa për sigurimin e informacionit mbi gjendjen gjyqësore nëpërmjet autoritetit të tyre qendror për shkëmbimin e informacionit për gjendjen gjyqësore. Informacioni nga regjistri i gjendjes gjyqësore, që sigurohet nëpërmjet një infrastrukture teknike të përbashkët, transmetohet në një format të standardizuar që lehtëson përkthimin automatik dhe njohjen e veprave penale.

Nëse një autoritet qendror (Zyra e Brendshme ose Zyra e Kurorës) merr një kërkesë për gjendjen gjyqësore nga një Shtet Anëtar i BE-së, kërkesa do t'i përcillet Autoritetit Qendror

të caktuar në Mbretërinë e Bashkuar për Shkëmbimin e të Dhënave mbi Gjendjen Gjyqësore, gjë që do të ngadalësojë procesin e kërkesës.

Kërkesat nga Shtetet që nuk janë Anëtare të BE-së

Kërkesat për gjendjen gjyqësore nga vendet jo anëtare të BE-së duhet të dorëzohen brenda kuadrit të bashkëpunimit për zbatimin e ligjit nëpërmjet NCA (Agjencia Kombëtare e Krimit).

Të Dhënat Gjyqësore

Lloji i Ndhmës	Bashkëpunimi për Zbatimin e Ligjit	Bashkëpunimi Gjyqësor
Të Dhënat Gjyqësore	✓	✓

Të gjitha çështjet penale në **Angli & Uells** dhe **Irlandën e Veriut**, fillojnë në Gjykatën e Magjistratëve. Çështjet më të rënda më pas transferohen në Gjykatën e Kurorës. Emri i gjykatës ku është shqiptuar dënimi dhe data e dënimit gjenden në vërtetimin e gjendjes gjyqësore (shih "Gjendja Gjyqësore" më sipër).

Në **Skoci**, prokurori mund të ngrejë një procedim në Gjykatën e Paqes ose Gjykatën e Sherifit. Çështjet që lidhen me krimet e rënda fillojnë në gjykatën e Sherifit dhe mund të vazhdojnë atje ose të kalojnë në Gjykatën e Lartë të Drejtësisë.

Vërtetimet e Gjykatës

Shtetet Anëtare të BE-së duhet të kërkojnë vërtetime gjyqësore **direkt nga gjykata përkatëse**. Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet një kopje e gjendjes gjyqësore (shih më sipër), e cila gjithashtu do të përmbajë emrin e gjykatës që ka dhënë dënimin. Të dhënat e kontaktit të gjykatave në **Angli dhe Uells**, **Irlandën e Veriut** ose **Skoci** mund të gjenden në faqet e tyre përkatëse të internetit.

Kërkesat nga Shtetet Anëtare të BE-së të cilat janë dërguar gabimisht tek UKCA ose në Zyrën e Kurorës do t'i përcillen gjykatës përkatëse (nëse emri i gjykatës është specifikuar nga vendi kërkuar), por kjo mund të ngadalësojë ndjeshëm përgjigjen.

Shtetet Jo Anëtare të BE-së duhet të kërkojnë vërtetime gjyqësore nga autoriteti qendror përkatës.

Vërtetimi Gjyqësor nga një Gjykatë e Magjistratëve (Memorandumi i Dënimit) duhet të përmbajë:

✓ Të dhënat personale të të Pandehurit.
✓ Nëse i pandehuri ishte i përfaqësuar apo jo.
✓ Lloji i veprës penale.
✓ Deklarimi për Fajësinë.
✓ Lloji i masës së dënimit (përfshirë kohëzgjatjen e dënimit të shqiptuar).

Vërtetimi Gjyqësor nga një Gjykatë e Magjistratëve (Vërtetim i Dënimit) duhet të përmbajë:
✓ Të dhënat personale të të Pandehurit.
✓ Të dhënat e përfaqësuesve ligjorë për mbrojtjen dhe prokurorisë.
✓ Nëse i pandehuri ishte i ndaluar gjatë gjykimit.
✓ Data e seancës.
✓ Data e shqiptimit të dënimit.
✓ Data e dënimit.
✓ Akuzat kundër të pandehurit, deklarimi për fajësinë dhe vendimin.

Nëse kërkohet <i>shprehimisht</i>, Gjykata mund të japë gjithashtu:
✓ Informacion mbi përdorimin e një përkthyesi gjatë procedurës, dhe nëse nuk përdoret, cilat janë arsyet.
✓ Identitetin e avokatit mbrojtës gjatë procedimeve.
✓ Statusi i çdo ankimi kundër shpalljes së Fajësisë(Ve)/ Dënimit(Ve).

Transkriptimi i Gjykimit / Arsyetimi i Dënimit të dhënë

Për të marrë transkriptimin e plotë të gjykimit ose arsyetimin e dënimit të dhënë, mund t'i bëhet një kërkesë autoritetit qendror përkatës për një transkriptim të regjistrimit, por kini parasysh se transkriptimi nuk ruhet për një kohë të pacaktuar. **Megjithatë, në shumicën e rasteve, kostoja e sigurimit të transkripteve ose arsyetimit të dënimit të dhënë duhet të përballohet nga autoriteti kërkues, pasi këto konsiderohen si kosto të jashtëzakonshme.**

Procesi në Angli, Uells dhe Irlandën e Veriut

Çështjet e rënda penale trajtohen nga Gjykata e Kurorës dhe një transkriptim i plotë gjyqësor i gjykimit mund të vihet në dispozicion.

Gjatë seancës nuk merren shënime me shkrim, por në vend të kësaj seancat e Gjykatës së Kurorës regjistrohen dhe regjistrimi mbahet për një numër të caktuar vitesh.

Transkriptet e nxjerra nga këto regjistrime mund të jenë shumë të shtrenjta. Kjo vlen pavarësisht nëse kërkesa bëhet nga një autoritet i Mbretërisë së Bashkuar ose nga një autoritet i huaj. **Kostoja e çdo transkripti është e lartë prandaj ajo duhet të përballohet nga autoriteti gjyqësor kërkuar.**

Në vend që të merrni të gjithë transkriptimin e seancës gjyqësore, është e mundur të merrni një pjesë më të vogël të transkriptimit e cila njihet si "**arsyetimi i dënimit të dhënë**". Kjo është pjesa e fundit e gjykimit ku gjykatësi në Gjykatën e Kurorës bën një përmbledhje të çështjes kur dënon të pandehurin. Megjithatë, kjo nuk është e njëjtë me përmbledhjen formale me shkrim që përdoret në juridiksione të tjera dhe shkalla e detajeve që gjyqtari do të japë (p.sh. rreth rrethanave të veprës penale dhe sjelljes së të pandehurit) do të jetë e ndryshme rast pas rasti.

Më shumë detaje mbi sigurimin e transkriptimeve, përfshirë çmimet, mund të gjenden në formularin [EX107](#).

Ju lutemi vini re se Gjykata e Magjistratëve (ku nisin të gjitha çështjet penale) nuk është një gjykatë e regjistrimeve, prandaj nuk do të ketë procesverbale gjyqësore për çështjet që shqyrtohen në këto gjykata.

Procesi në Skoci

Një transkriptim i procedimeve mbahet vetëm në rastet e krimeve të rënda kur i akuzuari akuzohet para një Gjyqtari/Sherifit dhe jurisë. Megjithatë, transkriptimi është pronë e gjykatës dhe duhet bërë një kërkesë në gjykatë për ta zbuluar atë. **Kostoja e çdo transkriptimi është e lartë prandaj do të kërkohej që ajo të përballohet nga autoriteti gjyqësor kërkuar.**

Kërkesë për Transkriptime ose Arsyetimi për Dënimin e Dhënë

- ✓ Në kopjen e raportit të UK-CRIS, nëse kërkesa është nga një shtet anëtar i BE-së, ose nëse kërkesa është nga një shtet jo anëtar i BE-së, duhet të përfshihet informacioni i mëposhtëm:
 - Emri i gjykatës përkatëse.
 - Data e seancës.
 - Data e dënimit.
- ✓ Konfirmim me shkrim në anglisht se kërkohej prova të tilla.

✓ **Konfirmim me shkrim në anglisht se autoriteti kërkues do të paguajë për kostot e sigurimit të provave të tilla.**

- Nëse këto konfirmime nuk merren në momentin e dorëzimit të kërkesës, përgjigja e plotë për kërkesën ka të ngjarë të vonohet.

Transferimi i përkohshëm i një të Burgosuri për Qëllime të Hetimit

Lloji i Ndhmës	Bashkëpunimi për Zbatimin e Ligjit	Bashkëpunimi Gjyqësor
Transferimi i Përkohshëm i të Burgosurve	X	✓

Në bazë të [seksionit 5](#) të Ligjit të Drejtësisë Penale (Bashkëpunimi Ndërkombëtar) 1990, një i burgosur i Mbretërisë së Bashkuar mund të transferohet **përkohësisht** jashtë vendit për të ndihmuar në hetimet dhe procedimet penale jashtë vendit. Të burgosurit nuk mund të transferohen nga Mbretëria e Bashkuar pa pëlqimin e tyre. Kërkesat për transferimin e përkohshëm të të burgosurve (Transferimi i Përkohshëm i të Burgosurve) duhet t'i dërgohen një autoriteti qendror (shikoni për më shumë detaje më poshtë).

Përpara autorizimit të transferimit, autoriteti qendror kompetent duhet të bindet se prania e të burgosurit nuk është më e nevojshme në atë pjesë të Mbretërisë së Bashkuar për qëllime hetimi ose procedimi dhe se transferimi nuk do të zgjasë periudhën e ndalimit të të burgosurit.

Kur transferimi është rënë dakord me autoritetin kërkues, autoriteti qendror merr masa që:

- I burgosuri në kujdestari të dërgohet në një pikë nisjeje në Mbretërinë e Bashkuar dhe të dorëzohet në kujdestarinë e një personi që përfaqëson autoritetin kërkues.
- I burgosuri të shoqërohet përsëri në Mbretërinë e Bashkuar nga autoriteti kërkues.
- Transferimi i mëpasshëm i të burgosurit në kujdestari nga vendi i mbërritjes në Mbretërinë e Bashkuar në vendin e tij/saj të ndalimit.

Kostoja e shoqërimit dhe strehimit të të burgosurve nga pika e nisjes nga Mbretëria e Bashkuar deri në pikën e kthimit në Mbretërinë e Bashkuar do të përballohet nga autoriteti kërkues.

Autoriteti qendror do të lidhet me shërbimet përkatëse të burgjeve në **Angli dhe Uells, Skoci dhe Irlandën e Veriut** për t'u siguruar që i burgosuri të dërgohet në një pikë nisjeje në Mbretërinë e Bashkuar dhe më pas të kthehet në burg kur autoriteti kërkues të ketë përfunduar procesin.

Transferimi i një të burgosuri në shtetin kërkues është i përkohshëm. Detyrimi për kthimin e personit në Mbretërinë e Bashkuar vazhdon edhe nëse i burgosuri është shtetas i shtetit kërkues. Duhet të sigurohet që transferimi të jetë i përkohshëm dhe se Mbretërisë së Bashkuar nuk do t'i kërkohet të kërkojë ekstradim që i burgosuri të kthehet në MB.

Procesi në Angli dhe Uells

Shërbimi i Burgjeve dhe Provës i Madhërisë së Tij (HMPPS) do t'i duhet një njoftim **prej të paktën tre javësh** për të organizuar transferimin e një të burgosuri nga një burg **Anglez** ose i **Uellsit** në një pikë nisjeje. Kjo për shkak se transferimet ndërmjet burgjeve bëhen me një transport të planifikuar të rezervuar dhe kërkohet njoftim paraprak. Më shumë informacion mund të gjendet [këtu](#).

Të dhënat e kontaktit të Shërbimit të Burgjeve dhe Provës i Madhërisë së Tij (HMPPS)

- ✓ Email: crossbordertransfers@justice.gov.uk
- ✓ Adresa:
Cross Border Transfer Section
HM Prison and Probation Service
Post Point 1.22, 1st Floor
Southern House
Croydon
CR0 1XG

Procesi në Irlandën e Veriut

Kur bëhet një kërkesë për transferimin e një të burgosuri nga një burg i **Irlandës së Veriut**, Shërbimi i Burgjeve në këtë juridiksion do të organizojë dorëzimin e të burgosurve në përputhje me udhëzimet e tyre operacionale. Për informacione të mëtejshme kontaktoni [Shërbimi i Burgut i Irlandës së Veriut](#), i cili është pjesë e Departamentit të Drejtësisë në Irlandën e Veriut.

Procesi në Skoci

Kur bëhet një kërkesë për transferimin e një të burgosuri në një burg Skocez, kërkesa duhet t'i dërgohet Zyrës së Kurorës, e cila do të lidhet me Shërbimin e Burgjeve Skoceze. Kur bihet dakord, kërkesa do të zbatohet nga Shërbimi i Burgjeve Skoceze, i cili gjithashtu do të presë një njoftim të paktën prej tre javësh për të njëjtat arsye të përcaktuara më sipër.

Megjithatë, duke pasur parasysh koston, burimet e personelit dhe vlerësimin e rrezikut për sigurinë publike gjatë transferimit ndërkufitar të një të burgosuri, duhet të merret parasysh mundësia që i burgosuri të japë dëshmi me video-konferencë ose, siç ka ndodhur në Skoci, i burgosuri ka dhënë dëshmi përpara një gjykate skoceze e përbërë nga prokurori, mbrojtja dhe gjyqtari i juridiksionit kërkues.

Për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni Njësinë e Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Zyrës së Kurorës ose, për organizimin praktik për kthimin e të burgosurve, Shërbimin e Burgjeve Skoceze.

Të dhënat e kontaktit të Shërbimit të Burgjeve Skoceze

- ✓ Telefon: **+44 131 244 8745**
- ✓ Adresa:
Scottish Prison Service Headquarters
Communications Branch
Room G20
Calton House
Redheughs Rigg
Edinburgh
EH12 9HW

Udhëzues për kërkesat për Transferimin e Përkohshëm të të Burgosurve në Shtetin Kërkues për të Bashkëpunuar në një Hetim

- ✓ Tregoni datat në të cilat kërkohet prania e të burgosurit jashtë vendit, duke përfshirë datat në të cilat fillon dhe ka të ngjarë të përfundojë procesi gjyqësor ose procedimet e tjera për të cilat kërkohet prania e të burgosurit.
- ✓ Jepni informacion me qëllim të marrjes së pëlqimit të të burgosurit për transferimin dhe siguron autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar se do të ndërmerren hapat e nevojshëm për ta mbajtur të burgosurin në kujdestari të sigurt, si për shembull:
 - nëse i burgosuri do të gëzojë imunitet nga ndjekja penale për vepra penale të mëparshme.
 - detaje mbi marrëveshjet e propozuara për marrjen e të burgosurit dhe kthimin e tij në Mbretërinë e Bashkuar.
 - detaje mbi llojin e strehimit të sigurt në të cilin i burgosuri do të mbahet në shtetin kërkues.
 - detaje mbi shoqërimin për në dhe nga strehimi i sigurt, i cili është në dispozicion jashtë vendit.

Transferimi i të Burgosurve me Qëllim të Vuajtjes së Pjesës së Mbetur të Dënimit me Burg (*Transferimi i të Burgosurve që nuk i nënshtrohen MLA*)

Autoritetet qendrore në kuadër të MLA-së **nuk** trajtojnë kërkesat për transferimin e të burgosurve për të kryer pjesën e mbetur të dënimit ose për ndonjë arsye tjetër që nuk lidhet me MLA-në.

Më shumë informacion rreth **Anglisë** dhe **Uellsit, Irlandës së Veriut** dhe **Skocisë** mund të gjendet [këtu](#).

Mostrat intime/jo-intime (përfshirë ADN-në)

Lloji i Ndhmës	Bashkëpunimi për Zbatimin e Ligjit	Bashkëpunimi Gjyqësor
Mostrat intime/jo-intime	✓	✓

Mbretëria e Bashkuar mund të marrë në konsideratë një kërkesë në kuadër të MLA-së për marrjen e mostrave intime nga një person; megjithatë, ajo nuk ka kompetencë ta detyrojë një person ta bëjë këtë.

ADN

Shkëmbimi i informacionit me Shtetet Anëtare të BE-së në lidhje me profilet e ADN-së që mbahen në bazën e të dhënave të ADN-së në Mbretërinë e Bashkuar kryhet në përputhje me Titullin II të Pjesës 3 të TCA. Këto shkëmbime përpunohen nëpërmjet UKICB (Byroja Ndërkombëtare e Krimin në Mbretërinë e Bashkuar) pranë NCA në bazë të bashkëpunimit të autoriteteve për zbatimin e ligjit. Informacioni i dhënë sipas këtij mekanizmi do të jetë **"vetëm në bazën e inteligjencës"**.

Jashtë të dhënave të shkëmbyera sipas mekanizmit TCA, një profil i ADN-së i cili mbahet nga Mbretëria e Bashkuar në përgjithësi **nuk transferohet** jashtë shtetit si pjesë e një kërkesë për MLA me qëllim përputhjen e tij me një profil të skenës së krimin në shtetin kërkuar. Nëse bëhet një kërkesë për përputhjen e ADN-së, autoriteti kërkuar duhet të dërgojë profilin e skenës së krimin në Mbretërinë e Bashkuar për përputhjen. Kjo mundëson krahasimin me të dhënat e personit në fjalë dhe me profilet e tjera të mbajtura në bazën e të dhënave kombëtare të ADN-së në Mbretërinë e Bashkuar. Kjo lloj kërkesë mund të bëhet edhe në bazë të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve për zbatimin e ligjit.

Megjithatë, në raste të caktuara, MB do të autorizojë transferimin e një profili të ADN-së që i përket MB-së jashtë vendit dhe kërkesa të tilla për MLA do të shqyrtohen rast pas rasti, duke marrë parasysh nevojën dhe proporcionalitetin e kërkesës. Shteti kërkuar duhet të deklarojë nëse profili i ADN-së kërkohet si provë dhe çdo kërkesë që duhet të plotësohet për të siguruar pranueshmërinë e tij.

Shenjat e gishtave

Ashtu si me ADN-në, Mbretëria e Bashkuar në përgjithësi kërkon të bëjë krahasime me gjurmët nga skenat e krimin jashtë vendit. Prandaj, autoriteti kërkuar duhet të dërgojë shenjat e krimin në Mbretërinë e Bashkuar për krahasim me bazën e të dhënave të MB. Kjo lloj kërkesë mund të bëhet edhe në bazë të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve për zbatimin e ligjit.

Megjithatë, kërkesat për MLA nëpërmjet të cilave kërkohet transmetimi i regjistrimeve të shenjave të gishtave të mbajtura në Mbretërinë e Bashkuar do të rishikohen rast pas rasti, duke marrë parasysh domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e kërkesës. Shteti kërkues duhet të deklarojë nëse regjistrimi i shenjave të gishtave kërkohet si provë dhe çdo kërkesë që duhet të plotësohet për të siguruar pranueshmërinë e tij.

Shtetet kërkuese duhet gjithmonë të marrin në konsideratë nëse të dhënat e kërkuara për ADN-në ose shenjat e gishtave mund të merren nëpërmjet bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve për zbatimin e ligjit, dhe jo nëpërmjet ndihmës së ndërsjellë juridike (MLA-së). Kërkesat për zbatimin e ligjit duhet të adresohen nëpërmjet Interpolit.

Oficerët e huaj në Mbretërinë e Bashkuar

Nëse oficerët nga shteti kërkues dëshirojnë të jenë të pranishëm gjatë ekzekutimit të një kërkesë për MLA, për shembull për të marrë pjesë gjatë një kontrolli ose të jenë të pranishëm gjatë marrjes në pyetje të një dëshmitari, kjo duhet të kërkohet edhe në kërkesën për MLA. Autoriteti qendror, së bashku me autoritetin që ekzekuton kërkesën në Mbretërinë e Bashkuar, do të përcaktojë nëse kjo është e përshtatshme.

Autoriteti kërkues duhet të japë arsye se pse oficerët nga shteti kërkues duhet të jenë të pranishëm. Mund të jetë e dobishme që oficeri hetues të jetë i pranishëm, për shembull:

- nëse bëhet fjalë për një rast shumë kompleks, ose
- kërkesa bëhet për kontroll dhe konfiskim.

Megjithatë, nëse nuk justifikohet që oficeri i shtetit kërkues të jetë i pranishëm, kjo kërkesë do të refuzohet.

Edhe nëse prania e oficerëve pranohet dhe kërkesa ekzekutohet me sukses, provat nuk do t'ju jepen automatikisht oficerëve që ishin të pranishëm gjatë ekzekutimit. Megjithatë, ndonjëherë mund të jetë praktike transferimi i provave nëpërmjet oficerëve shoqërues. Në këtë rast policia e Mbretërisë së Bashkuar duhet të kërkojë autorizim nga autoriteti qendror i Mbretërisë së Bashkuar.

Njoftim për Mbretërinë e Bashkuar për oficerët e zbatimit të ligjit që udhëtojnë në Mbretërinë e Bashkuar

Forcat përkatëse të policisë vendore në Mbretërinë e Bashkuar **duhet** të njoftohen paraprakisht nëse oficerët për zbatimin e ligjit të shtetit kërkues do të udhëtojnë në MB. Megjithatë, nëse shteti kërkues nuk është në gjendje të kontaktojë/identifikojë forcat e policisë vendore, NCA mund të ndihmojë dhe të përcjellë njoftimin.

Forcat përkatëse të policisë vendore në Mbretërinë e Bashkuar **duhet** gjithashtu të njoftohen paraprakisht nëse oficerët për zbatimin e ligjit do të udhëtojnë për në Mbretërinë e Bashkuar për të kryer një mision zyrtar **edhe nëse ai nuk është në kuadër të MLA-së**.

Para udhëtimit, oficerët duhet të kontrollojnë faqet e Internetit të qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, të tilla si:

- [Hyrja në Mbretërinë e Bashkuar - GOV.UK \(www.gov.uk\)](http://www.gov.uk)

Transferimi i Procedimeve

Lloji i Ndihmës	Bashkëpunimi për Zbatimin e Ligjit	Bashkëpunimi Gjyqësor
Transferimi i Procedimeve	X	✓

Procedimi duhet të zhvillohet në juridiksionin ku ka ndodhur pjesa më e madhe e krimit ose, nëse kjo nuk është e mundur, ku është ndjerë dëmi. Në praktikë, sistemi i të drejtës zakonore të Mbretërisë së Bashkuar për zhvillimin e procesit kontestues dhe marrjes në pyetje të dëshmitarëve në kohë reale është përgjithësisht i papajtueshëm me procesin ku procedimet janë transferuar nga një juridiksion tjetër.

Mbretëria e Bashkuar **nuk** është palë nënshkruese e [Konventën së Këshillit të Evropës të vitit 1972 për Transferimin e Procedimeve në Çështje Penale](#) dhe ka një rezervë ndaj Konventës Evropiane [të Këshillit të Evropës të vitit 1959](#) për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale e cila thotë se “...Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar rezervon të drejtën për të mos zbatuar Nenin 21”.

Për kërkesat hyrëse për transferimin e procedimeve në Mbretërinë e Bashkuar vendoset rast pas rasti.

Shënim: Një llogari bankare në Mbretërinë e Bashkuar nuk është një lidhje e mjaftueshme për të transferuar procedimet në Mbretërinë e Bashkuar.

Udhëzues për kërkesat për Transferimin e Procedimeve
✓ Vepra që çon në procedimin penal duhet të jetë një vepër penale si në MB ashtu edhe në vendin kërkues.
✓ Duhet të ketë prova për një lidhje të qartë dhe të vendosur në Mbretërinë e Bashkuar.
✓ Kërkesa duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme. Çdo vonesë e paarsyeshme (më shumë se 5 vjet) duhet të shpjegohet.
✓ Kërkesa nuk është <i>de minimis</i> (shikoni Pjesën 2 të këtyre udhëzimeve).
✓ Ajo duhet të përkthehet në anglisht (përfshirë dokumentet mbështetëse).

Nëse pranohet, kërkesa do t'i përcillet forcave përkatëse të policisë ose agjencisë për zbatimin e ligjit, dhe çështjes do t'i jepet i njëjti status dhe përparësi siç do t'i jepej një rasti të ngjashëm të brendshëm.

Në **Angli, Uells** dhe **Irlandën e Veriut** i takon policisë ose agjencisë për zbatimin e ligjit të vendosë nëse do të kryhet një hetim.

Në **Skoci**, Zyra e Kurorës do të udhëzojë policinë të nisë një hetim dhe do të vlerësojë rezultatet përpara se të vendosë nëse do të ndiqet penalisht.

Transferimi i Raportimeve të Krimit

Lloji i Ndhmës	Bashkëpunimi për Zbatimin e Ligjit	Bashkëpunimi Gjyqësor
Transferimi i Raportimeve të Krimit	✓	X

Transmetimi i raportimeve të krimit në MB duhet të bëhet ndërmjet agjencive për zbatimin e ligjit nëpërmjet kanaleve të Interpolit.

Transferimi i raportimit të një krimi në MB i referohet një situatë ku një individ i cili ka qenë viktimë e një krimi në Mbretërinë e Bashkuar zgjedh ta raportojë atë tek autoritetet në vendin e tij ose të saj të banimit në vend të Mbretërisë së Bashkuar. Kjo mund të jetë për disa arsye, duke përfshirë pengesat gjuhësore, mungesën e të kuptuarit të sistemit ligjor të Mbretërisë së Bashkuar ose për shkak të traumës ose shqetësimit në atë moment. Pritshmëria është që detajet e krimit të supozuar të dërgohen në Mbretërinë e Bashkuar për zbatimin e ligjit për të vlerësuar kryerjen e një hetimi.

Shkëmbimi Spontan i informacionit

Lloji i Ndhmës	Bashkëpunimi për Zbatimin e Ligjit	Gjyqësor Bashkëpunimi
Shkëmbim Spontan	✓	✓

Nëse një vend ka informacion në lidhje me një vepër penale që mund të jetë e rëndësishme për Mbretërinë e Bashkuar ose ka të bëjë me një vepër penale në Mbretërinë e Bashkuar, atëherë autoriteti qendror mund ta marrë këtë informacion dhe, nëse pranohet, do t'ia kalojë këtë organit përkatës të zbatimit të ligjit. Ky proces është i mundur në bazë të disa traktateve dypalëshe dhe shumëpalëshe për MLA-në. Shkëmbimi spontan i informacionit është i mundur edhe nëpërmjet bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve ligj-zbatuese, i cili do të kanalizohet nëpërmjet NCA-së.

Europol ose Eurojust

Në raste urgjente, informacioni spontan nga Shtetet Anëtare të BE-së mund të transmetohet nëpërmjet Europolit ose Eurojust-it në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit BE-MB.

Mashtrimi

Action Fraud është qendra kombëtare e raportimit të mashtimit dhe krimit kibernetik ku duhet të raportohet mashtrimi, nëse dikush ka qenë viktimë e mashtimit, ose krimit kibernetik në **Angli, Uells dhe Irlandën e Veriut**.

Raportimi mund të bëhet edhe në gjuhë të tjera duke vizituar faqen <http://www.actionfraud.police.uk/languages>

Për mashtrimet në **Skoci** ju lutemi raportoni direkt tek Policia e Skocisë.

Ekipet e Përbashkëta të Hetimit

Ekipi i Përbashkët Hetimor (JIT) është një marrëveshje me shkrim ndërmjet dy ose më shumë vendeve për të kryer një hetim me një qëllim të caktuar dhe për një periudhë të caktuar kohore me synim ndjekjen penale në një ose më shumë vende.

JIT u mundëson anëtarëve të ekipit nga vende të ndryshme të shkëmbejnë informacion pa nevojën e një letër-porositë zyrtare dhe për këtë arsye është një *alternativë* ndaj MLA-së; përparësitë e krijimit të JIT mund të përfshijnë:

- ✓ Hetimet paralele zhvillohen in tandem: marrëveshje për vendin e ndjekjes penale, "Ditët e Veprimit të Përbashkët" dhe shkëmbimi i thjeshtuar i informacionit.
- ✓ Efikasiteti: shmang nevojën për të përdorur kanale të MLA-së shpesh më të ngadalta për të shkëmbyer informacion (burime, kosto dhe kursime në kohë) dhe aftësi për të ndarë informacionin në "kohë reale".
- ✓ Financimi: Financimi i Eurojust për JTI i disponueshëm për të gjitha vendet e JTI-së në të cilat merr pjesë të paktën një Shtet Anëtar i BE-së (mbulon kostot e udhëtimit, përkthimit dhe pajisjeve).
- ✓ Përfshirja e **çdo** vendi në botë (me kusht që të ekzistojë baza e nevojshme ligjore).

Një JIT që përfshin Mbretërinë e Bashkuar mund të krijohet sipas një instrumenti të vetëm, të zbatueshëm reciprokisht:

- Neni 20 i Protokollit të Dytë Shtesë të Konventës Evropiane të vitit 1959 për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale.
- Neni 19 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (UNTOC)

- Neni 9 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope.
- Neni 49 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC).

Eurojust ka zhvilluar ekspertizë në hartimin dhe negocimin e JIT-ve dhe është gjithashtu një burim i mundshëm për financimin e JIT-së për Shtetet Anëtare të BE-së. Prokurorët ose gjykatat që konsiderojnë krijimin e një EPH me MB-në këshillohen të konsultohen me Departamentin e tyre Kombëtar pranë Eurojust për të diskutuar më tej çështjen e propozuar.

Pjesa 4 - Rikuperimi i Aseteve dhe Hetimet Financiare

Ky seksion përshkruan format e ndihmës që mund të ofrojë MB në lidhje me rikuperimin e asetëve dhe hetimet financiare.

Autoritetet jashtë vendit mund të gjejnë se [Manuali për Rikuperimin e Pasurive: Një Udhëzues për Praktikantët, Botimi i Dytë](#), botuar nga Iniciativa e Bankës Botërore për Rikuperimin e Pasurive të Vjedhura dhe Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin, është një burim i dobishëm informacioni mbi çështjet e rikuperimit të asetëve.

Gjurmimi i Aseteve

Lloji i Ndihmës	Bashkëpunimi për Zbatimin e Ligjit	Bashkëpunimi Gjyqësor
Gjurmimi i Aseteve	✓	X

Gjurmimi/identifikimi i pasurisë duhet të bëhet në bazë të bashkëpunimit për zbatimin e ligjit nëpërmjet [Agjencisë Kombëtare të Krimin](#) ose kanaleve të tjera të bashkëpunimit për zbatimin e ligjit si për shembull [CARIN](#). Është e rëndësishme të bëhet dallimi ndërmjet gjurmimit të asetëve dhe kërkesës për informacion që shërben si provë në lidhje me pronësinë dhe vlerën e asetëve me vendndodhje në MB (shih më poshtë).

Ju lutemi vini re se **nuk ka një regjistër qendror të llogarive bankare në MB**. Aty ku është e mundur, informacioni për vendndodhjen dhe pronësinë e llogarive bankare duhet të kërkohej në bazë të bashkëpunimit me autoritetet e zbatimit të ligjit përpara se të bëhet një kërkesë për MLA.

Shikoni [Pjesën 3](#) të këtyre udhëzimeve për informacion se si të merrni prova bankare me anë të një urdhri për dorëzimin e provave dhe shikoni seksionet më poshtë për kërkesat për kufizim dhe sekuestrim të asetëve.

Mbretëria e Bashkuar ka një sërë kompetencash hetimore për marrjen e provave vetëm për qëllimin e një hetimi për rikuperimin e asetëve (me dënim dhe pa dënim). Është e rëndësishme të theksohet se agjencitë e përmbarimit të Mbretërisë së Bashkuar do të vendosin se cila kompetencë hetimore është më e përshtatshme për t'u përdorur kur ekzekutohet një kërkesë për prova gjatë hetimeve për rikuperimin e asetëve.

Provat mund të kërkojnë për qëllimet e hetimit penal kryesor, dhe më pas mund të përdoren për çdo hetim ose procedim që lidhet me rikuperimin e aseteve nëse merret pëlqimi ose nëse një përdorim i tillë në të ardhmen parashikohet në kërkesën për MLA.

Ngrirja (Kufizimi) në Procedimet Penale

Lloji i Ndihmës	Bashkëpunimi për Zbatimin e Ligjit	Bashkëpunimi Gjyqësor
Ngrirja e Aseteve	X	✓

Kërkesat për Ngrirjen e Aseteve

(Jo sipas procedurave të përcaktuara në Titullin XI të Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet BE dhe MB, shih më poshtë)

Qëllimi i një kërkesë për ngrirje është ruajtja e vlerës së aseteve që ndodhen në MB për qëllime të konfiskimit (në MB kjo lloj ngrirjeje njihet si "kufizim"). Përpara se të bëni një kërkesë për ngrirjen e aseteve që ndodhen në MB, duhet të plotësoni sa vijon në mënyrë që informacioni përkatës të mund të përfshihet në kërkesën për kufizim:

Përpara se të bëni një Kërkesë për Ngrirjen e Aseteve

- Përdorni bashkëpunimin për zbatimin e ligjit nëpërmjet NCA-së, Qendrës Ndërkombëtare të Koordinimit Kundër Korrupsionit - IACCC (për çështjet e korrupsionit të madh) ose rrjeteve ndërkombëtare të rikuperimit të aseteve si CARIN për të identifikuar dhe gjurmuar asetet në Mbretërinë e Bashkuar (shiko më sipër).
- Përdorni, sipas nevojës, MLA për të marrë **prova** për asetet në MB (për shembull, për të marrë prova bankare siç përmendet më sipër).

Pasi të merret ky informacion, një kërkesë për ngrirje mund t'i bëhet Mbretërisë së Bashkuar nëpërmjet Autoritetit Qendror të MB. Vini re se kërkesat për ngrirjen e aseteve gjithashtu kërkojnë **kriminalitet të dyfishtë**. Në kërkesë duhet të përfshihen sa vijon:

Kërkesa për Kufizimin e Aseteve të sigurojë ose konfirmojë si më poshtë:
✓ Ekziston kriminalitet i dyfishtë.
✓ Detajet e hetimit penal në vazhdim (që nuk ka përfunduar) për një krim që lidhet me blerjen e pronës ose pastrimin e parave, ose procedimet në shtetin kërkues (ju lutemi vini re se nuk është e nevojshme të jenë ngritur akuza përpara se të bëhet një kërkesë ose të lëshohet një urdhër i brendshëm për ngrirje në gjykatat tuaja).

✓ Faktet materiale të çështjes – ku përfshihet çdo mbrojtje ose shpjegim i paraqitur nga i pandehuri/i dyshuari për pronësinë ose vendndodhjen e aseteve.
✓ Pse ekzistojnë baza të arsyeshme për të besuar se i akuzuari/i pandehuri i përmendur në kërkesë ka përfituar (duke marrë para ose pasuri të tjera) nga veprimtaria e tij kriminale (vini re se dyshimi i arsyeshëm verifikohet në fazën e hetimit).
✓ Pse ekzistojnë baza të arsyeshme për të besuar se prona mund të jetë e nevojshme për ekzekutimin e një urdhri të huaj që është bërë ose që mund të bëhet.
✓ Pse urdhri është i nevojshëm – përfshini një shpjegim që do t'i mundësojë gjykatës të të vlerësojë nëse ekziston rrezik real që prona e identifikuar të shpërndahet nëse nuk lëshohet një urdhër.
✓ Emri, adresa, kombësia, data dhe vendi i lindjes dhe vendndodhja aktuale e të dyshuarit(ve) ose të akuzuarit(ve), sjellja kriminale e të cilëve ka shkaktuar procedimet e parashikuara të konfiskimit dhe mbajtjes.
✓ Të dhënat e pronës që do të kufizohet në MB, personat që e zotërojnë atë dhe marrëdhëniet ndërmjet të dyshuarit dhe pronës (kjo është e rëndësishme nëse prona që do të kufizohet mbahet në emër të një pale të tretë, për shembull kompani ose ndonjë person tjetër).
✓ Nëse është dhënë ndihmë paraprake në lidhje me këtë rast (ku përfshihet ndihma për gjurmimin e aseteve) dhe, nëse po, të dhënat e autoriteteve të MB të përfshira dhe detajet e çdo ndihme që është marrë tashmë. Nëse nuk është kërkuar ose ofruar ndihmë më parë, kjo duhet të tregohet qartë.
✓ Kur është e zbatueshme, detajet e urdhrave të gjykatës që janë lëshuar tashmë në shtetin kërkuar kundër të dyshuarit në lidhje me pronën e tij ose të saj dhe një kopje e njësisë me origjinalin e një urdhri të tillë, e vërtetuar nga një person në cilësinë e tij si gjyqtar, gjyqtar magjistrat ose zyrtar i gjykatës përkatëse të Shteti kërkuar ose nga një zyrtar i autoritetit kërkuar. Në rast se nuk janë lëshuar urdhra nga gjykata, kjo duhet të shprehet qartë (ju lutemi vini re se nuk është e nevojshme të keni një urdhër të brendshëm për të kërkuar ngrirjen në MB).
✓ Nëse është e mundur, renditni shkurtimisht të gjitha pasuritë e njohura të të dyshuarit <u>jashtë</u> MB.
✓ Tregoni qartë se prona në Mbretërinë e Bashkuar duhet të kufizohet pasi nuk ka prona/asete të mjaftueshme diku tjetër. Nëse ka prona / asete të cilat ndodhen diku tjetër, por ato nuk mund të ngrihen, kjo duhet të shprehet qartë nga autoriteti kërkuar.

- ✓ Tregoni në mënyrë të qartë nëse kundërshtoni ose jo që gjykatat në Mbretërinë e Bashkuar t'i lejojnë të pandehurit qasje në fondet e kufizuara për t'i përdorur për shpenzimet e jetesës dhe shpenzimet ligjore, dhe **se jeni dakord që gjykatat në MB të vlerësojnë se çfarë është një shumë e arsyeshme.**

Pa këtë informacion, një gjykatë mund të mos jetë në gjendje të lëshojë një urdhër për ngrirjen e asetëve në mënyrë efektive. Nuk është e detyrueshme që të lëshohet një urdhër brenda vendit për t'i kërkuar Mbretërisë së Bashkuar të ngrijë asetet.

Nëse kërkesa pranohet, autoriteti qendror vendos se kush duhet ta ekzekutojë kërkesën dhe ia përcjell atë autoritetit ekzekutues përkatës. Autoriteti ekzekutues do ta shqyrtojë kërkesën përpara se të aplikojë në gjykatë për një urdhër ngrirjeje (i njohur në MB si urdhër kufizimi) në përputhje me [Ligjin për Produktet e Krimin 2002, Urdhri 2005 \(Kërkesat dhe Urdhrat e Huaj\)](#) dhe [seksionin 447](#) të Ligjit për Produktet e Krimin 2002.

Një prokuror i CPS [Shërbimi i Prokurorisë së Kurorës] ose SFO mund t'ju kontaktojë drejtpërdrejt për të marrë informacion të mëtejshëm për të ndihmuar në bërjen e kërkesës përkatëse në gjykatat e MB.

Autoriteti ekzekutues që merret me kërkesën do të bëjë kërkesat e duhura në gjykatë për asetet që do të ngrihen dhe do të informojë autoritetin kërkues sapo të jetë bërë kjo.

Një kopje e urdhrit të ngrirjes në Mbretërinë e Bashkuar duhet t'i dorëzohet të dyshuarit dhe çdo personi tjetër që dihet se është prekur nga ky urdhër sa më shpejt të jetë e mundur. Gjykatat e Mbretërisë së Bashkuar do të kërkojnë një konfirmim se kjo është bërë, përndryshe gjykata e Mbretërisë së Bashkuar mund të anulojë urdhrin.

Ju lutemi vini re: një gjykatë në Mbretërinë e Bashkuar gjithashtu mund ta anulojë urdhrin nëse procedimet nuk kanë filluar ose urdhri i konfiskimit nuk është regjistruar brenda një kohe të arsyeshme. Prokurorët e Mbretërisë së Bashkuar mund të kërkojnë përditësime të rregullta mbi çështjen për t'u siguruar që kjo kërkesë do të vazhdojë të përmbushet dhe do të informojnë shtetin kërkues për çdo kundërshtim të mundshëm ndaj urdhrit të ngrirjes (përfshirë anulimin e mundshëm).

Kërkesat për ngrirjen e Instrumenteve të Krimin

"Instrumentet e krimin" mbulojnë çdo pronë që ka qenë, është ose ka për qëllim të përdoret në lidhje me kryerjen e një vepre penale. [Seksioni 4 i Ligjit Penal \(Bashkëpunimi Ndërkombëtar\) i vitit 1990, Urdhri i vitit 2005 \(Zbatimi i Urdhrave të Konfiskimit Jashtë Vendit\)](#)<http://www.legislation.gov.uk/ukxi/2005/3180/contents/made> ("Urdhri i Konfiskimit 2005") i mundëson një gjykatë të Mbretërisë së Bashkuar të nxjerrë një urdhër ngrirjeje bazuar në një kërkesë nga jashtë.

Kërkesat për ngrirjen e instrumenteve janë të ngjashme me kërkesat për ngrirjen e aseteve (shih më sipër).

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian - Kërkesat për Ngrirjen e Aseteve

Ju lutemi vini re: dispozitat e ligjit të Bashkimit Evropian për njohjen reciproke nuk vlejnë më për Mbretërinë e Bashkuar.

Kërkesat për ndihmë në lidhje me ngirjen e asetëve duhet të bëhen sipas dispozitave të Titullit XI të Pjesës 3 [të Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit MB-BE](#).

Kërkesat për ngirjen e asetëve duhet të bëhen në formularin e duhur bashkëngjitur Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit; një mostër e këtij formulari mund të gjendet [këtu](#). Ju lutemi vini re se ky formular duhet të përdoret vetëm për kërkesat për ngirjen e asetëve, dhe jo për prova për të mbështetur një hetim për rikuperimin e asetëve, i cili duhet të kërkohet veçmas.

Formulari duhet t'u dërgohet autoriteteve qendrore të mëposhtme:

Angli, Uells dhe Irlanda e Veriut:

Autoriteti Qendror i Mbretërisë së Bashkuar - UKCA-AFC@homeoffice.gov.uk

Skoci

Zyra e Kurorës – coicu@copfs.gov.uk

Konfiskimi dhe Humbja në Procedimet Penale

Lloji i Ndhmës	Bashkëpunimi për Zbatimin e Ligjit	Bashkëpunimi Gjyqësor
Konfiskimi i Aseteve	X	✓

Kërkesat për Konfiskim

(Jo sipas procedurave të përcaktuara në Titullin XI të Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet BE dhe MB, shih më poshtë)

Konfiskimi është regjistrimi dhe ekzekutimi i urdhrit të shtetit kërkues ndaj asetëve në Mbretërinë e Bashkuar. Kërkesat për konfiskimin e pasurive kërkojnë **kriminalitet të dyfishtë**.

Kërkesa për Konfiskimin e Pasurisë duhet të sigurojë ose konfirmojë si më poshtë:	
✓	Ekziston kriminalitet i dyfishtë.
✓	Personi i përmendur në urdhër është shpallur fajtor dhe nuk ka bërë ankim kundër këtij dënimi.
✓	Urdhri është në fuqi dhe nuk i nënshtrohet ankimit.
✓	E gjithë ose një shumë e caktuar e shumës së pagueshme sipas urdhrit mbetet e papaguar në territorin e shtetit kërkues ose prona tjetër e rikuperueshme sipas urdhrit mbetet e pa-rikuperuar atje.
✓	Qëllimi i urdhrit është të rikuperojë pronën ose vlerën e pasurisë së marrë në lidhje me kryerjen e një krimi (për shembull, gjykata duhet të ketë arritur në përfundimin se prona është ose përfaqëson të ardhura nga krimi).
✓	Urdhri i nxjerrë mund të zbatohet jashtë juridiksionit të shtetit kërkues.
✓	Origjinali ose një kopje e njësisë me origjinalin e urdhrit duhet t'i bashkëngjitet kërkesës.
✓	Faktet materiale të çështjes – përfshirë çdo mbrojtje ose shpjegim të paraqitur nga i pandehuri/i dyshuari, çdo fakt që ka dalë në dritë pas nxjerrjes së urdhrit fillestar të ngrirjes (nëse është bërë).
✓	Emri, adresa, kombësia, data dhe vendi i lindjes dhe vendndodhja aktuale e personave, sjellja kriminale e të cilëve ka shkaktuar procedimet e parashikuara të konfiskimit ose humbjes.
✓	Të dhënat e pronës që do të konfiskohet në MB, personat që e zotërojnë atë dhe marrëdhëniet ndërmjet të dyshuarit dhe pronës (kjo është e rëndësishme nëse prona që do të konfiskohet mbahet në emër të një pale të tretë, për shembull kompani ose ndonjë person tjetër).
✓	Nëse është dhënë ndihmë paraprake në lidhje me këtë rast (ku përfshihet ndihma për gjurmimin e aseteve) dhe, nëse po, të dhënat e autoriteteve të MB të përfshira dhe detajet e çdo ndihme që është marrë tashmë. Nëse nuk është kërkuar ose ofruar ndihmë më parë, kjo duhet të tregohet qartë.
✓	Detajet e të gjithë urdhrave të gjykatës që janë lëshuar tashmë në shtetin kërkues kundër të dyshuarit në lidhje me pronën e tij ose të saj dhe një kopje e njësisë me origjinalin e një urdhri të tillë, e vërtetuar nga një person në cilësinë e tij si gjyqtar, magjistrat ose zyrtar i gjykatës përkatëse të Shteti kërkues ose nga një zyrtar i autoritetit kërkues. Në rast se nuk është lëshuar më parë një urdhër gjykate për ngrirjen e pronës, kjo duhet të tregohet qartë.
✓	Nëse është e mundur, renditni shkurtimisht të gjitha pasuritë e njohura të të dyshuarit jashtë MB.

Nëse kërkesa pranohet, autoriteti qendror do të vendosë se kush do ta ekzekutojë kërkesën dhe do t'ia përcjellë atë autoritetit përkatës në përputhje me [Ligjin për Produktet e Krimin 2002, Urdhri 2005 \(Kërkesat dhe Urdhrat e Jashtëm\)](#) dhe [seksionin 447](#) të Ligjit për Produktet e Krimin 2002. Pasi të referohet, dhe me kusht që të plotësohen të gjitha kushtet, autoriteti ekzekutues mund t'i kërkojë gjykatës të regjistrojë urdhrin e jashtëm të konfiskimit. Kjo mundëson ekzekutimin e kushteve të urdhrin.

Asgjësimi i Aseteve

Pasi asetet të jenë rikuperuar, ato do të asgjësohen në një nga tre mënyrat:

1. Çështjet e rikuperimit të aseteve që lidhen me korrupsionin të cilat përfshihen në fushën e zbatimit të dispozitave të [Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit](#) (UNCAC) do të trajtohen në përputhje me Nenin 57 të kësaj Konvente.
2. Çështjet që nuk përfshihen në dispozitat e UNCAC mund të ndahen me vendin pritës nëse kjo parashikohet nga ndonjë ligj ndërkombëtar në fuqi ose nëse MB hyn në një marrëveshje për ndarjen e aseteve.
3. Nëse nuk ka marrëveshje zyrtare me një vend ose territor, ekzistojnë marrëveshje administrative që lejojnë ndarjen e aseteve rast pas rasti.

Në mungesë të një marrëveshjeje për ndarjen e aseteve, ato do të mbahen nga MB dhe do të disponohen në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Çështjet e ndarjes së aseteve dhe riatdhesimit trajtohen nga Ekipi Ndërkombëtar i Rikuperimit të Aseteve pranë Zyrës së Brendshme (international-assetrecovery@homeoffice.gov.uk).

Konfiskimi i Instrumenteve të Krimin

Urdhrat e konfiskimit lejojnë privimin ose asgjësimin e pasurisë që është përdorur, ose që synohet të përdoret, në kryerjen e një veprë penale. Ligji dhe procedura janë të ngjashme me konfiskimin siç përshkruhet më sipër.

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian - Kërkesat për Konfiskim

Ju lutemi vini re: dispozitat e ligjit të Bashkimit Evropian për njohjen reciproke nuk vlejnë më për Mbretërinë e Bashkuar.

Kërkesat për ndihmë në lidhje me konfiskimin duhet të bëhen sipas dispozitave të Titullit XI të Pjesës 3 të Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit MB-BE dhe duhet t'u dërgohen [autoriteteve qendrore përkatëse](#) (UKCA dhe Zyra e Kurorës).

Kërkesat për konfiskimin e aseteve duhet të bëhen në formularin përkatës bashkëngjitur Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit. Ju lutemi vini re se ky formular duhet të përdoret vetëm për kërkesat për ngrirjen e aseteve, dhe jo për prova, i cili duhet të kërkohet veçmas.

Kërkesat për rikuperim pa gjykim

Mbretëria e Bashkuar gjithashtu mund të ndihmojë në ngrirjen dhe rikuperimin e aseteve pa një gjykim (rikuperim civil). Kjo mund të bëhet vetëm nëpërmjet ndihmës së ndërsjellë juridike dhe nuk mund të bëhet nëpërmjet kanaleve të zbatimit të ligjit. Përpara se të bëhet një kërkesë, kanalet e zbatimit të ligjit duhet të përdoren për të identifikuar qartë asetet e mbajtura në MB.

Për ngrirjen e aseteve, nuk është e nevojshme të dërgoni një urdhër të brendshëm. Kjo është thelbësore për rikuperimin përfundimtar. Mbretëria e Bashkuar ka një sistem fleksibël të rikuperimit të aseteve dhe mund të ofrojë ndihmë kur rruga (çështje penale ose pa dënim) nuk përcaktohet domosdoshmërisht në një fazë të hershme të procesit të rikuperimit të aseteve.

Urdhrat pa dënim mund të përdoren kur dënimi nuk është i mundur. Megjithatë, legjislacioni i Mbretërisë së Bashkuar për konfiskimin pa dënim kërkon që prona e identifikuar të jetë fituar si rezultat ose në lidhje me sjelljen kriminale (ose mund të gjurmohet drejtpërdrejt origjina e saj).

Kërkesa për ngrirjen ose konfiskimin pa dënim duhet të sigurojë ose konfirmojë sa vijon:

- ✓ Nuk është e nevojshme të ketë një hetim penal ose dënim, por sjellja kriminale në bazë të rikuperimit të aseteve duhet të përbëjë një vepër penale në MB ose do të përbënte një vepër penale në MB nëse do të kryhej këtu.
- ✓ Kërkesa duhet të identifikojë "pronën përkatëse" në Mbretërinë e Bashkuar.
- ✓ Urdhri që është lëshuar ose mund të lëshohet ka të bëjë me pasurinë që është gjetur ose besohet se është fituar si rezultat ose në lidhje me sjelljen kriminale.

✓ Për rikuperimet përfundimtare, urdhri është në fuqi dhe nuk i nënshtrohet ankimit.
✓ E gjithë ose një shumë e caktuar e shumës së pagueshme sipas urdhrit përfundimtar mbetet e papaguar në territorin e shtetit kërkues ose prona tjetër e rikuperueshme sipas urdhrit mbetet e pa-rikuperuar atje.
✓ Pse është "e drejtë dhe e paanshme" të nxjerrësh një urdhër në MB, duke marrë parasysh interesat e çdo personi që mund ta ketë fituar pronën "me mirëbesim".
✓ Urdhri përfundimtar i nxjerrë mund të zbatohet jashtë juridiksionit të shtetit kërkues.
✓ Originali ose një kopje e njësisë me origjinalin e urdhrit përfundimtar të konfiskimit duhet të dorëzohet së bashku me kërkesën për konfiskim (për ngrirjen nuk është i nevojshëm asnjë urdhër).
✓ Faktet materiale të çështjes, duke përfshirë mënyrën se si prona është e lidhur me veprimtarinë, pronën që është objekt i çështjes dhe çdo shpjegim për mënyrën se si është fituar pasuria që mund të jetë dhënë nga ndonjë prej personave gjatë hetimit.
✓ Pse urdhri është i nevojshëm.
✓ Emri, adresa, kombësia, data dhe vendi i lindjes dhe vendndodhja e tanishme e çdo individi.
✓ Të dhënat e pronës që do të konfiskohet në MB, personat që e zotërojnë atë dhe lidhja ndërmjet të dyshuarit dhe pronës (kjo është e rëndësishme nëse prona që do të ngrihet mbahet në emër të një pale të tretë, për shembull një kompani ose ndonjë person tjetër).
✓ Nëse është dhënë ndihmë paraprake në lidhje me këtë rast (ku përfshihet ndihma për gjurmimin e aseteve) dhe, nëse po, të dhënat e autoriteteve të MB të përfshira dhe detajet e çdo ndihme që është marrë tashmë. Nëse nuk është kërkuar ose ofruar ndihmë më parë, kjo duhet të tregohet qartë.
✓ Kur është e zbatueshme, të dhënat e urdhrave të gjykatës që janë lëshuar tashmë në shtetin kërkues dhe një kopje e njësisë me origjinalin e një urdhri të tillë, e vërtetuar nga një person në cilësinë e tij si gjyqtar, gjyqtar magjistrat ose zyrtar i gjykatës përkatëse të Shteti kërkues ose nga një zyrtar i autoritetit kërkues. Në rast se nuk është lëshuar asnjë urdhër gjykate, kjo duhet të tregohet qartë.
✓ Nëse është e mundur, renditni shkurtimisht të gjitha pasuritë e njohura të të dyshuarit jashtë MB.
Të kihet parasysh:
✓ Kërkesat duhet të jenë në përputhje me detyrimet e të drejtave të njeriut.

- | |
|---|
| ✓ Afati i parashkrimit është 20 vjet, por në rast se gjykata konstaton se ka pasur një fshehje të qëllimshme të fakteve të rëndësishme për procedimet, afati mund të zgjatet. |
| ✓ Çdo pasuri mund të mbulohet. |
| ✓ Çështjet mund të zgjidhen përpara se të lëshohet një urdhër përfundimtar. |

Nëse kërkesa pranohet, autoriteti qendror vendos se kush duhet ta ekzekutojë kërkesën dhe ia përcjell atë autoritetit ekzekutues përkatës. Autoriteti ekzekutues do ta shqyrtojë kërkesën përpara se t'i drejtohet gjykatës për të marrë një urdhër ngrirjeje në MB ose për të regjistruar urdhrin e ngrirjes ose konfiskimit jashtë vendit, në përputhje me [Ligjin për Produktet e Krimin 2002, Urdhrin 2005 \(Kërkesat dhe Urdhrat e Jashtëm\)](#).

Pjesa 5 - Fjalorthi

Ky seksion ofron një listë të termave ose fjalëve të gjetura ose që lidhen me ndihmën juridike të ndërsjellë, me shpjegime të shkurtra.

A		
AKRO	Zyra e Gjendjes Gjyqësore	ACRO menaxhon Sistemin e Informacionit të të Dhënave Penale të Mbretërisë së Bashkuar (UK-CRIS), i cili shkëmben informacion mbi dënimet me Shtetet Anëtare të BE-së. Kjo përgjegjësi i është caktuar Shefit të Policisë të forcave tona pritëse nga Sekretari i Zyrës së Brendshëm, i cili ia delegon atë ACRO-s. Jashtë BE-së, ACRO shkëmben të dhëna informuese me të gjitha vendet jashtë BE-së nëpërmjet kanaleve të Interpolit.
Deklaratë nën Betim		Një term që i referohet një betimi që bëhet nga një person i cili deklaron se informacioni i përfshirë në deklaratën me shkrim është i vërtetë. Këto dokumente shpesh përgatiten për shoqërimin e deklaratave të dëshmitarëve për të vërtetuar se informacioni i dhënë është faktikisht i saktë kur dëshmia paraqitet në gjykatë.
Rikuperimi i Aseteve		Është procesi i marrjes së aseteve, si prona, automjete apo para të gatshme, nga individë që i kanë fituar ato me veprimtari të paligjshme.
Konfiskimi i Aseteve		Privimi i përhershëm i pasurisë me urdhër të një gjykate ose autoriteti tjetër kompetent. I njohur edhe si mbajtja (asete nën zotërimin e autoriteteve konfiskohen). Konfiskimi kryhet nëpërmjet një procedure gjyqësore ose

		administrative në të cilën pronësia e fondeve ose asetëve të caktuara i kalon shtetit. Personi ose subjekti që ka interes në fonde ose asete të tjera humbet të gjitha të drejtat në parim ndaj fondeve të konfiskuara.
B		
Territoret Britanike Jashtë Vendit	BOTs	Ekzistojnë 14 territore Britanike jashtë vendit: Bermudet, Gjibraltari, Ishujt e Virgjër Britanikë, Ishujt Kajman, Ishujt Falkland, Ishujt Turks dhe Kaikos, Anguilla, Territori Britanik i Oqeanit Indian, Gjeorgjia Jugore dhe Ishujt Jugorë Sanduiç, Territori Britanik Antarktik , Shën Helena dhe territoret në varësi të saj (Ascension dhe Tristan de Cunha), Montserrat, Grupi i Ishujve Pitcairn dhe Zonat e Bazës Sovrane në Qipro. Ato nuk janë pjesë e Mbretërisë së Bashkuar; ato vetëqeverisen dhe kanë juridiksione të veçanta, por mbështeten tek Mbretëria e Bashkuar për çështje të tilla si politika e jashtme apo mbrojtja.
BF (UKBF)	Forcat e Kufirit	Komanda e zbatimit të ligjit në Zyrën e Brendshme, mbron kufijtë e Mbretërisë së Bashkuar duke kryer kontrolle të imigracionit dhe doganave për njerëzit dhe mallrat që hyjnë në Mbretërinë e Bashkuar.
Konventa e Budapestit		Konventa Evropiane për Luftën kundër Krimin Kibernetik (CETS 185), e njohur më shumë si Konventa e Budapestit, është marrëveshja kryesore për të luftuar ndërkombëtarisht krimin kibernetik. Ajo kërkon që Palët në Konventë të kenë ligjet dhe procedurat e duhura për të luftuar krimin kibernetik dhe të jenë në gjendje të ofrojnë ndihmë për vendet e tjera, si p.sh. sigurimin e

		provave. Mbretëria e Bashkuar ratifikoi Konventën e Budapestit në vitin 2011. Bërthama e Konventës përbëhet nga tre pjesë kryesore që mbulojnë veprat penale, ligjin procedural dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Ajo gjithashtu përmban përkufizime dhe seksione që mbulojnë fusha të tilla si aderimi dhe zbatimi territorial.
C		
Autoriteti Qendror		Subjekti i caktuar për pranimin e kërkesave për MLA. Në Mbretërinë e Bashkuar, autoriteti qendror do t'ia përcjellë kërkesën autoritetit përkatës zbatues (shih Zyra e Kurorës, HMRC dhe UKCA).
Akuza (penale)		Në një çështje penale, vendimi për ngritjen e akuzës merret nëse ka prova të mjaftueshme që ofrojnë baza reale për dënimin e çdo të dyshuari për çdo akuzë. Në varësi të llojit dhe rëndësisë së veprës penale të kryer, ky vendim merret nga shërbimi i policisë ose shërbimi përkatës i prokurorisë (Angli, Uells dhe Irlanda e Veriut).
CICA	Ligji për Bashkëpunimin (Ndërkombëtar) në fushën e Krimin 2003	Një ligj i Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar që përfshin legjislacionin e MB-së për ndihmën e ndërsjellë në çështjet penale.
CoE	Këshilli i Evropës	Një organizatë ndërkombëtare e themeluar në prag të Luftës së Dytë botërore për të mbështetur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit në Evropë. Mbretëria e Bashkuar ishte një nga themeluesit e organizatës dhe vazhdon të jetë anëtare e saj.
Thirrje		Në sistemin ligjor Skocez, një thirrje është një dokument zyrtar i dërguar nga

		Prokurori Fiskal ku tregohet data dhe ora në të cilën personi duhet të paraqitet në gjykatë për t'iu përgjigjur akuzës ose akuzave kundër tij dhe jep detaje për akuzat e supozuara, të cilat janë ngritur ndaj jush.
Rikuperimi Civil		Të ardhurat nga krimi mund të rikuperohen gjatë procedimit civil para Gjykatës së Lartë kundër pasurisë që mund të vërtetohet se është përfituar nga krimi. Rikuperimi civil mund të përdoret kur nuk është e mundur të jepet një dënim, ose kur është dhënë një dënim, por nuk është lëshuar urdhër konfiskimi, ose kur interesi publik do të shërbejë më mirë duke përdorur rikuperimin civil sesa duke kërkuar nxjerrjen e një urdhri konfiskimi. Kjo do të përfshijë rastet kur të dyshuarit kanë shkuar jashtë vendit për të shmangur hetimin ose krimi është kryer jashtë vendit në mënyrë që të mos ndiqet penalisht nga gjykatat e Mbretërisë së Bashkuar. Mund të kërkojë një urdhër ngrirjeje ruajtjen e aseteve derisa të lëshohet një urdhër për rikuperim civil.
Kërkesat Zyrtare	Njihen si letër porosi dhe kërkesa zyrtare	Kërkesë me shkrim për ndihmë juridike ose gjyqësore, e dërguar nga autoriteti qendror i një vendi tek autoriteti qendror i një tjetri kur kërkon prova nga juridiksioni i huaj. Në MB ky term zakonisht lidhet me kërkesat për MLA nga juridiksionet e ligjit civil.
Kompensimi		Dëmshpërblim monetar që i jepet një viktime të identifikuar gjatë procedimeve dhe që vërtetohet se ka pësuar dëme.
Konfiskimi	Shih Konfiskimi i	

	Aseteve	
CPS	Shërbimi i Prokurorisë së Kurorës	Shërbimi i Prokurorisë për çështjet penale për Anglinë dhe Uellsin.
Gjykata e Kurorës		Në Angli dhe Uells, Gjykata e Kurorës merret me çështje të rënda penale, zakonisht ekziston një juri, e cila vendos nëse i pandehuri është fajtor apo i pafajshëm, dhe një gjykatës që vendos për çështjet e ligjit dhe vendos dënimin për ata që shpallen fajtorë.
Juridiksionet në Varësinë e Kurorës	CD	Brenda Ishujve Britanikë ka tre territore ishullore të njohura si Juridiksionet në Varësinë e Kurorës; këto janë Bailiwicks of Jersey dhe Guernsey, të cilat përbëjnë Channel Islands (Ishujt e Kanalit) dhe Isle of Man (Ishulli i Manit). Juridiksionet në Varësinë e Kurorës nuk janë pjesë e Mbretërisë së bashkuar, por janë zotërimi vetëqeverisës të Kurorës Britanike. Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar është përgjegjëse për fusha të caktuara të politikës si mbrojtja dhe punët e jashtme.
COPFS	Zyra e Kurorës dhe Zyra Fiskale e Prokurorit.	Autoriteti qendror për kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike për Skocinë. E njohur edhe si "Zyra e Kurorës".
D		
I pandehuri		Dikush që akuzohet se ka kryer një krim dhe është akuzuar për një vepër penale. Në fushën e rikuperimit të aseteve në MB: një person që i nënshtrohet një urdhri konfiskimi bazuar në një dënim.
Gjykimi dy herë për të njëjtën vepër penale		Parimi që një person, fizik ose juridik nuk duhet të jetë subjekt i një ndjekjeje të dytë penale për të njëjtën vepër penale pas lirimit ose dënimit të ligjshëm, as

		nuk duhet të jetë subjekt i "dënimit" të shumëfishtë për të njëjtën vepër penale. Njihet edhe si "ne bis in idem" (latinisht).
E		
EAW	Urdhër Arresti Evropian	Një sistem që mundëson ekstradimet ndërmjet shteteve anëtare të BE-së. Mbretëria e Bashkuar pushoi së qeni pjesë e kësaj skeme nga data 31 Dhjetor 2020.
ECHR/KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut	Një konventë ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe liritë politike në Evropë. E hartuar në vitin 1950 nga Këshilli i sapokrijuar i Evropës në atë kohë, Konventa hyri në fuqi më 3 shtator 1953. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës janë palë në Konventë dhe anëtarët e rinj pritët të ratifikojnë konventën në rastin më të parë. Mbretëria e Bashkuar vazhdon të jetë anëtare e Këshillit të Evropës dhe është palë nënshkruese e KEDNJ.
ECRIS	Sistemi i Informacionit për të Dhënat Kriminale në Evropë	Një sistem që mundëson shkëmbimet e të dhënave kriminale ndërmjet shteteve anëtare të BE-së. Mbretëria e Bashkuar pushoi së qeni pjesë e kësaj skeme nga data 31 Dhjetor 2020 (Shih MB-CRIS).
EIO	Urdhër Evropian për Hetimin	Mbretëria e Bashkuar pushoi së qeni pjesë e kësaj skeme nga fundi i periudhës së tranzicionit më 31 dhjetor 2020.
BE	Bashkimi Evropian	Mbretëria e Bashkuar u largua nga BE më 31 janar 2020. Janë 27 shtete anëtare.
EUMS	Shteti Anëtar i Bashkimit Evropian	Një shtet anëtar i Bashkimit Evropian (gjithashtu SHA).

Eurojust	Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në fushën e Drejtësisë Penale	Me qendër në Hagë, ajo u mundëson autoriteteve gjyqësore kombëtare të Shteteve Anëtare të BE-së të punojnë së bashku në luftën kundër krimit të rëndë të organizuar ndërkufitar. Mbretëria e Bashkuar është e përfaqësuar në Eurojust.
Konventa Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Çështjet Penale 1959		Në bazë të kësaj Konvente të Këshillit të Evropës, palët nënshkruese bien dakord t'i japin njëra-tjetrës masën më të gjerë të ndihmës së ndërsjellë për mbledhjen e provave, dëgjimin e dëshmitarëve, ekspertëve dhe personave të ndjekur penalisht, etj.
Europol		Agjencia e zbatimit të ligjit e BE-së me seli në Hagë, mbështet 27 Shtetet Anëtare të BE-së në luftën e tyre kundër terrorizmit, krimit kibernetik dhe formave të tjera të rënda dhe të organizuara të krimit. Ata gjithashtu punojnë me shumë shtete që nuk janë partnere të BE-së dhe organizata ndërkombëtare; Mbretëria e Bashkuar ka përfaqësinë e saj në Europol.
F		
FCA	Autoriteti i Sjelljes Financiare	Rregullatori i firmave të shërbimeve financiare dhe tregjeve financiare në Mbretërinë e Bashkuar.
FIU	Njësia e Hetimit Financiar	Agjencia qendrore kombëtare që merr, kërkon, analizon dhe shpërndan informacion financiar mbi të ardhurat e krimit.
FNO	Autor i Veprave Penale që është Shtetas i Huaj	Një person që dihet ose dyshohet se është i përfshirë në veprimtari kriminale dhe që nuk mund të konfirmohet si shtetas britanik.
Konfiskim	Shih Konfiskimi i	

	Aseteve	
Urdhri i Ngrirjes		Ndalimi i përkohshëm i transferimit, konvertimit, disponimit ose lëvizjes së pronës ose marrja e përkohshme e ruajtjes ose kontrollit të pronës në bazë të një urdhri të lëshuar nga një gjykatë ose autoritet tjetër kompetent. Termi përdoret në mënyrë të ndërsjellë me sekuestrimin dhe kufizimin. Termi "bashkëngjitur", "ruajtje" ose "bllokim" mund të përdoret gjithashtu.
H		
HMRC	Zyra e të Ardhurave dhe Doganave e Madhërisë së Saj	Autoriteti për mbledhjen e tatimeve direkte dhe indirekte i Mbretërisë së Bashkuar, një autoritet qendror i caktuar për kërkesat e ndihmës së ndërsjellë juridike në lidhje me hetimin e çështjeve tatimore dhe doganore.
Zyra e Brendshme		Në qendër të sigurisë dhe prosperitetit ekonomik të Mbretërisë së Bashkuar, është departamenti kryesor i Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar për imigracionin dhe pasaportat, politikën e drogës, krimin, sigurinë nga zjarri, kundër-terrorizmin dhe policinë.
HRA	Ligji për të Drejtat e Njeriut 1988	Një ligj për zbatimin e mëtejshëm të të drejtave dhe lirive të garantuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (shih KEDNJ).
I		
ILOR	Letër-porosi Ndërkombëtare	Dokument zyrtar nëpërmjet të cilit kërkohet ndihmë e ndërsjellë juridike (shih gjithashtu LoR).
IE (HOIE)	Autoriteti i Zbatimit të Ligjit për Imigracionin	Një komandë brenda Zyrës së Brendshme përgjegjëse për parandalimin e abuzimit, gjurmimin e shkelësve të ligjit për imigracionin dhe

		rritjen e zbatimit të ligjit për imigracionin.
Instrumentet		Asetet e përdorura për të lehtësuar krimin, të tilla si një makinë ose varkë të cilat përdoren për të transportuar drogë.
Ndihmë joformale		Çdo aktivitet apo ndihmë e ofruar pa qenë nevojshme të bëhet një kërkesë formale për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike. Mund të ketë legjislacion që lejon këtë lloj ndihme.
Interpol		Një organizatë ndërqeveritare me mbi 190 vende anëtare që ndihmojnë policinë dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit nga vende të ndryshme të punojnë së bashku. Në çdo vend, Byroja Qendrore Kombëtare e INTERPOLIT (NCB) shërben si pikë qendrore e kontaktit me Sekretariatit e Përgjithshëm dhe NCB-të e tjera.
Transmetimet e Interpolit		Qarkullimi i informacionit lidhur me krimin në një grup vendesh në një rajon specifik të botës.
Njoftimet e Interpolit		Qarkullimi global i informacionit që lidhet me krimin tek autoritetet për zbatimin e ligjit.
J		
JICC	Qendra e Përbashkët Ndërkombëtare e Krimit	Një njësi e specializuar që drejton punën e Mbretërisë së Bashkuar mbi krimin ndërkombëtar. Qendra e Përbashkët Ndërkombëtare e Krimit konsolidon dhe forcon kapacitetin e MB-së për bashkëpunimin dhe koordinimin ndërkombëtar të zbatimit të ligjit.
JIT	Ekipi i Përbashkët i Hetimit	Një ekip hetimi për veprat penale i përbërë nga njësi nga dy ose më shumë vende.

L		
LoR	Letër-porosi	Dokument zyrtar nëpërmjet të cilit kërkohet ndihmë e ndërsjellë juridike (shih gjithashtu ILOR).
M		
Gjykata e Magjistratëve		Të gjitha çështjet penale në Angli, Uells dhe Irlandën e Veriut, fillojnë në gjykatën e magjistratëve. Në gjykatën e magjistratëve nuk ka juri dhe ato kanë kompetenca të kufizuara në dhënien e dënimit; çështjet më të rënda dërgohen në Gjykatat e Kurorës. CICA S15 dhe 30 seancat zhvillohen në një gjykatë të caktuar të magjistratëve.
ML	Pastrimi i Parave	Çdo akt apo tentativë për të maskuar burimin e parave apo pasurive që rrjedhin nga veprimtaria kriminale. Pastrimi i parave përfshin fshehjen e origjinës dhe përdorimin e aseteve të paligjshme.
MLA	Ndihmë e Ndërsjellë Juridike	Një metodë formale bashkëpunimi ndërmjet vendeve për marrjen e ndihmës ndërkufitare në hetimin ose ndjekjen e veprave penale. Ky bashkëpunim mund të përfshijë marrjen dhe mbledhjen e provave, kryerjen e kontrolleve, ngrirjen e aseteve dhe sigurimin e dëshmitarëve për seancat dëgjimore.
MLAT	Traktati për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike	Traktatet e Ndihmës së Ndërsjellë Juridike (MLAT) në çështjet penale janë traktate dypalëshe ose shumëpalëshe të lidhura ndërmjet dy ose më shumë vendeve për të ofruar ndihmë dhe bashkëpunim ndërkombëtar.
MO	Modus Operandi	Në latinisht për "mënyra e funksionimit". Një mënyrë ose metodë specifike për të

		bërë diçka. Në çështjet penale, kjo mund të jetë metoda që përdor i dyshuari për të kryer krime, shpesh në të njëjtin model si krimet e mëparshme.
MPS	Policia Metropolitane	Shërbimi i Policisë për zonën e Londrës së Madhe.
MS/SHA	Shteti Anëtar	Një shtet anëtar i Bashkimit Evropian (gjithashtu EUMS).
N		
NCA	Agjencia Kombëtare e Krimit	Agjencia Kombëtare e Krimit drejton luftën e Mbretërisë së Bashkuar kundër krimit të rëndë dhe të organizuar. E njohur më parë si SOCA (Agjencia e Krimit të Rëndë dhe të Organizuar).
NCB	Byroja Kombëtare e Krimit	Në MB kjo njësi ndodhet brenda NCA dhe njihet si Byroja Ndërkombëtare e Krimit (UK-ICB).
NPCC	Këshilli Kombëtar i Shefave të Policisë	NPCC bashkon forcat policore në Mbretërinë e Bashkuar për të ndihmuar policinë të koordinojë operacionet.
O		
OCG	Grup i Krimit të Organizuar	Përkufizohet si një grup që kryen me qëllim aktivitete kriminale dhe përbëhet nga tre ose më shumë persona që bien dakord të veprojnë së bashku për të arritur këtë qëllim.
P		
PACE	Ligji për Policinë dhe Provat për Vepra Penale 1984	Ligji i Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar i cili vendosi një kornizë legislative për kompetencat e oficerëve të policisë në Angli dhe Uells për të luftuar krimin. Ligji gjithashtu përcakton kodet e praktikave të mira për ushtrimin e këtyre kompetencave.

PEPs	Personat e Ekspozuar Politikisht	Personat që kanë mbajtur ose që u janë besuar funksione të rëndësishme publike, për shembull, krerët e shteteve ose qeverive, politikanë të lartë, zyrtarë të lartë të qeverisë, gjyqësorë dhe ushtarakë, drejtues të lartë të korporatave shtetërore, zyrtarë të rëndësishëm partiakë. Marrëdhëniet e biznesit me anëtarët e familjes ose bashkëpunëtorët e ngushtë të PEP-ve përfshijnë rreziqe të reputacionit të ngjashme me ato të vetë PEP-ve.
PF	Prokurori Fiskal	Prokurori Penal Skocez.
PO	Urdhër për Dorëzimin e Provave	Urdhri për Dorëzimin e Provave kërkon paraqitjen e një materiali specifik (për shembull, informacion i mbajtur nga institucionet financiare). Policia dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit aplikojnë në gjykatë për një urdhër për dorëzimin e provave, shpesh në lidhje me një konfiskim, pastrim parash ose hetim për rikuperimin civil.
POCA	Ligji për Produktet e Krimin 2002	Akti i Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar i cili parashikon konfiskimin ose rikuperimin civil të të ardhurave nga krimi dhe përmban legjislacionin kryesor të pastrimit të parave në Mbretërinë e Bashkuar.
PPS	Shërbimi i Prokurorisë Publike	Autoriteti kryesor i prokurorisë në Irlandën e Veriut, me përgjegjësi për marrjen e vendimeve për ndjekjen penale në të gjitha çështjet e hetuara nga policia dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit.
Të Ardhurat nga Krimi ose POC		Çdo pasuri që rrjedh ose merret, drejtpërdrejt ose tërthorazi nëpërmjet kryerjes së një veprë penale.

PSNI	Shërbimi i Policisë i Ishullit Verior	Shërbimi i Policisë i Irlandës së Veriut.
Policia e Skocisë		Shërbimi i Policisë i Skocisë.
R		
Urdhër Kufizimi		Një urdhër <u>i cili i mundëson</u> gjykatës të <u>ngrijë asetet</u> e një <u>të pandehuri</u> , veçanërisht për t'i parandaluar atij ose asaj <u>t'i nxjerrë</u> ato <u>jashtë vendit</u> . Urdhrat e kufizimit zbatohen për asetet, nëse ato pasuri mund të jenë subjekt i Një Urdhri Konfiskimi pasi jepet një dënim. Një urdhër kufizimi parandalon zhdukjen e pasurive.
S		
SFO	Zyra e Mashtrimeve të Rënda	Heton dhe ndjek penalisht mashtrime të rënda ose komplekse, ryshfetet dhe korrupsionin.
Fletë - Thirrje		Fletë-thirrja e dëshmitarit është një dokument i lëshuar nga gjykata që e detyron dëshmitarin të paraqitet. Në Skoci kjo njihet si "thirrje."
I dyshuar		Dikush që mund të ketë kryer një krim ose dikush që është nën hetim për kryerjen e krimit.
T		
TCA	Marrëveshja e Tregtisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar dhe BE	Zyrtarizoi marrëdhëniet ndërmjet MB-së dhe BE-së pas daljes së MB-së nga BE-ja dhe përfundimit të periudhës së tranzicionit pas datës 31 Dhjetor 2020.
U		
UKCA	Autoriteti Qendror i Mbretërisë së Bashkuar	Autoriteti qendror për kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike në Angli, Irlandën e Veriut dhe Uells, pjesë e

		Zyrës së Brendshme.
UK-CRIS	Sistemi i Informacionit për të Dhënat Kriminale në Mbretërinë e Bashkuar	Sistemi i MB-së i shkëmbimit të të dhënave kriminale me shtetet anëtare të BE-së (shiko ECRIS).
UKICB	Mbretëria e Bashkuar – Byroja Ndërkombëtare e Krimin	E organizuar nga NCA (Agjencia Kombëtare e Krimin), ajo përfshin Byronë Qendrore Kombëtare të Mbretërisë së Bashkuar për INTERPOL-in dhe Njesisë Kombëtare të Europolit në MB.
V		
Viktima:		Një person që ka pësuar dëm, përfshirë dëmtim fizik, mendor ose emocional ose humbje ekonomike e cila është shkaktuar drejtpërdrejt nga një vepër penale. Një viktimë është gjithashtu një dëshmitar.
D		
Dëshmitar:		Një person që ka parë ose mund të japë dëshmi për një krim ose incident. Një dëshmitar mund të jetë gjithashtu një ekspert/profesionist (për shembull, eksperti mjeko-ligjor) ose një dëshmitar që dëshmon për karakterin e personit të akuzuar.